

MATERIALE DHE DOKUMENTE**DAVID LUKA****HYRJE E VEPRËS “VËZHGIME, KËRKIME DHE STUDIME NË LËMIN E GJUHËS SHQIPE” NË 10 VËLLIME (PJESA E TRETË)***

Vëllimi i gjashtë ndahet në tri pjesë: 1. Histori e gjuhës shqipe; 2. Fonetikë historike e gjuhës shqipe dhe 3. Gramatikë historike e gjuhës shqipe.

Historisë së gjuhës shqipe i kushtohen gjashtë shkrime, prej të cilëve katër janë të një rëndësie të veçantë, sepse trajtojnë probleme kyçe të kësaj fushe, për të cilat është shkruar e diskutuar shumë, por ku ende nuk janë arritur mendime të njësuara.

Paraprin shkrimi me titull *“A mund të konceptohen dukuritë gjuhësore në një çast të dhënë të zhvillimit të tyre?”*, që përpiqet jo vetëm t’i japë teorikisht përgjigje pyetjes së shtruar aty, por edhe të përlligjë metodën e përdorur në përpjekjen për zgjidhjen e problemit të kohës së formimit të gjuhës shqipe si edhe periodizimit të historisë së saj.

Shkrimi i dytë titullohet *“Rreth problemit të vendit të formimit të gjuhës shqipe”*. Pasi bëhet një parashtrim i gjatë e i thellë i argumenteve, kryesisht ndihmesë e mirëfilltë e punës sonë shkencore, jepet edhe përfundimi për vendin e formimit të gjuhës shqipe:

“Duke përmbyllur paraqitjen e bërë deri më tani, mund të nxirren këto përfundime: Treva e sotme shqiptare (aty ku ende sot flitet shqip) është vetëm një pjesë e vendit të formimit të gjuhës shqipe, sepse ajo në lashtësi ka qenë më e gjerë, duke përfshirë edhe vise të tjera ku banonin ilirë. Kjo trevë gjuhësore protoshqipfolëse ka pësuar gjatë kohëve tkurrje, rruddhje e ngjeshje, pra është një zonë ngushtimi të pandërprerë gjatë kohëve dhe për asnjë rast zonë ekspansioni. Edhe në qoftë se ka patur ndonjëherë ndonjë lëvizje a “hapje”, ajo gjithsesi ka qenë e parëndësishme dhe, duke ndodhur brenda trojeve etnike, nuk

* Në këtë rubrikë po botojmë në disa numra të revistës *Hyrjen* e përgatitur nga prof. David Luka për veprën e tij “Vëzhgime, kërkime dhe studime në lëmin e gjuhës shqipe” në 10 vëllime. Hyrja paraqet përmbajtjen e vëllimeve të veçanta të veprës, objektin dhe pikësynimet, parimet dhe metodat e zbatuara në veprë. Për arsye të gjerësisë së materialit, punimi është ndarë në disa pjesë. (Shën. i red.)

ka ndikuar në historinë e shqiptarëve. Teza e Stadtmüllerit nuk del e saktë, sepse një ndër argumentet kryesore të saj (mungesa e elementeve latine), flet në të kundërtën e përhapjes së shqipes nga një zonë e ngushtë si ajo e Matit. Përkimet me rumunët nuk e prishin logjikën e faktit. Ato mund t'i përkasin një kohe më të lashtë kur skajet e vendit të formimit të gjuhës shqipe mund të kenë takuar me skajet e vendit ku flitej rumanisht, pra të jenë huazime të ndërsjella; ndërkaq nuk mund të mos pranohet edhe mundësia e një nënshtrese (substrati) të përbashkët të të dy gjuhëve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për elementet e trakishtes në shqipe, të cilat mund të jenë pasojë e fqinjësisë së tyre që në antikitet, duke mos u përjashtuar këtu edhe mundësia që ilirishtja dhe trakishtja të kenë pasur pika takimi dhe afëri në gjuhë. Gjithsesi, me materialin që kemi në dorë deri më sot, teza që i bie shqiptarët autoktonë në trojet ku banojnë që së lashti, dhe se vendi i formimit të gjuhës së tyre të jetë kryer në po këto troje, paraqitet deri më tani, më e sakta dhe më e argumentuara.”

Shkrimi i tretë titullohet “Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe”.

Pasi merren në analizë mendimet e dhëna nga gjuhëtarë të ndryshëm, veçanërisht ato të Sh. Demirajt, parashtrohen përfundimet tona për problemin në fjalë. Ne mendojmë se koha e formimit të gjuhës shqipe duhet vështruar gjithsesi në pikëpamje gjuhësore dhe të vërtetohet po me argumente gjuhësore, të cilat duhet të përfshijnë të katër nënsistemet e strukturës gjuhësore të shqipes. Faktet jogjuhësore, qofshin këto edhe historike, arkeologjike etj. duhet vetëm të mbështesin argumentet gjuhësore. Në mungesë të leksikut të ilirishtes duhet të bëjmë objekt studimi huazimet latine të shqipes, të cilat, duke i vështruar në ndërrimet fonetike që paraqesin, mund t'i ndajmë në dy shtresa. E para, u nënshtrohet ndërrimeve të njëjta njëlloj si elementi i trashëguar. E dyta, pëson ndërrime të reja fonetike, që përlligjin fillimin e një gjuhë të re edhe me tipare të ndryshme nga “nëna” e saj. Ndërrimet morfonologjike (metafonia etj.) së bashku me dukuritë e tjera (sistemi i theksimit, rotacizmi, bigëzimet e lashta dialektore, ndikimi i pakët i latinishtes në strukturën morfologjike të shqipes përballë huazimeve të shumta në leksik etj.), na kanë dhënë dorë të arrijmë në përfundimin se:

Shqipja u formua si gjuhë disi e ndryshme nga “nëna” e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek. I-IV të erës sonë, periudhë që paraqitet më intensive në ndërrimet që kanë kushtëzuar këtë kalim. Gjatë kësaj periudhe shqipja përvijoi tiparet gjuhësore duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e “nënës” së saj, ilirishtes, por duke formuar në të njëjtën kohë tipare të reja që e bënë të dallohej nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj. Në këtë shkrim ne mundohemi t'i qasemi zgjidhjes së problemit jo me arsyetime të karakterit historik e me marrëdhënie probabilitetit, po kryesisht me argumente gjuhësore, që përbëjnë themelin e një gjuhe.

Shkrimi i katërt me titull “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve (Çështje parimesh dhe metode)” rreh të analizojë kriteret dhe metodën për analizën e këtij problemi ende të pazgjidhur përfundimisht. Pasi parashtrihen me kritikë mendimet e dhëna deri më sot nga gjuhëtarë të ndryshëm, ndalemi e analizojmë me hollësi mendimin e G. Schrammit.

Teza e Gottfried Schramm (në veprën *Anfänge des albanischen Christentums*) për prejardhjen e shqiptarëve nga një fis malësor trakas i quajtur *bes*, i kthyer që herët në besimin kristian, banorët e të cilit rreth shek IX, për shkak të përndjekjeve të bullgarëve paganë, u vendosën prapa Durrësit, përafërsisht në krahinën e *Arbnisë*, është kundërshtuar nga tre studiues: I. Schütz¹, K. Gostentschnigg² dhe R. Ködderitzsch³. Dy prej autorëve të sipërm (I. Schütz dhe K. Gostentschnigg) nuk merren drejtpërdrejt me analizën e hollësishme të veprës, por kryesisht me metodën e përdorur prej autorit, ndërsa R. Ködderitzsch merret edhe me analizën gjuhësore të saj.

I. Schütz, në artikullin e parë, tregohet më i ashpër në kundërshtimet e veta; ndërsa tek artikulli i dytë, më racional. Ai pasi i përmend Schrammit proverbin latin “*unus testis - nullus testis*”, citon vërejtjen që vetë Schrammi i bën përfundimeve të E. Çabejt: “Me sa përpikmëri dhe me sa kujdes argumentohet këtu? Sa në mënyrë të ndërgjegjshme ndahet e sigurta prej gjasave dhe gjasa prej vetëm të mundshmes? ...”⁴, duke i kujtuar se këto fjalë i përshtaten më tepër se kurrkujt atij vetë.

Schrammi është historian që operon me mjete gjuhësore. Ai merr të gatshme përfundimet e atyre gjuhëtarëve që çojnë ujë drejt tezës që ky mbron, pa i shoshitur ato dhe, veçanërisht, pa i vështruar në përqsaje edhe me përfundimet e dijetarëve shqiptarë dhe pa qenë i informuar sa duhet për fonologjinë historike të gjuhës shqipe. Për përfundimet e Schrammit mund të perifrazohet një nen i *Kanunit të Lekës*: “Ai që shkon në gjyq me këmbë të veta e me mend të tjetërkujt, paguen gjobën”.

Në qoftë se ka të drejtë K. Gostentschnigg kur shkruan se “Teza e Shramit mbi prejardhjen bese të shqiptarëve - qoftë kjo vetëm një lëmsh hipotezash ose një e vërtetë e zbuluar historike - çon përsëri ujë në mullirin e

¹ I. Schütz, *Shënime mbi monografinë e prof. dr. Gottfried Schramm-it “Anfänge des albanischen Christentums”*, në përmbledhjen “Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare”, Tiranë, 1995. *Konvertimi i shqiptarëve dhe prejardhja e shqipes (Disa vërejtje rreth dy monografive të kohëve të fundit)*, në përmbledhjen “Krishterimi ndër shqiptarë”, po aty, f. 393 v.

² Kurt Gostentschnigg, *Rreth historisë së trajtimit të problemit të etnogjenezës së shqiptarëve*, në rev. “Studime filologjike”, nr. 1-2, 1999, f. 33 v.

³ *Shqipja dhe trakishtja*, po aty.

⁴ “Wie streng, wie sorgfältig wird hier argumentiert? Wie gewissenhaft wird das Gesicherte vom Wahrscheinlichen, das Wahrscheinliche vom bloß Möglichen geschieden? ...”

variantit historik të shkruar nga serbët⁵, atëherë qëllimet e kësaj vepre, shkruar në vitin 1994, ndihmojnë jo vetëm “teoritë” e serbëve, por në mënyrë të tërthortë edhe synimet e tyre në përpjekjet për ringjalljen e “Stara Srbija”.

Si përfundim, mbetemi me mendimin e E. Çabejt, dhënë pothuaj 50 vjet më parë, se për problemin e burimit të gjuhës shqipe (përkate edhe për çështjet e tjera që lidhen me të, e këtu kryesisht autoktonia e shqiptarëve) “... mbetet në thelb i pazgjidhur”⁶, me gjithë përparimet që janë bërë në këto vitet e fundit, veçanërisht nga studiuesit shqiptarë, në këtë fushë të dijes.

Shkrimi i pestë, titullohet “*Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*”. Që në nisje, shkruhet: “Problemi i periodizimit të historisë së gjuhës shqipe përbën një ndër çështjet e rëndësishme të saj, që ende nuk ka gjetur zgjidhje të kënaqshme. Ndërkaq, ai paraqitet gjithsesi i vështirë, sepse mungojnë ‘pikat’ mbështetëse dhe veçanërisht ‘baza’ e nisjes. Duke miratuar mendimin e Sh. Demirajt që “... periodizimi duhet të nisë qysh nga ajo periudhë, kur shqipja është formuar përfundimisht si një gjuhë cilësisht e ndryshme nga ‘nëna’ e saj ...”, problemi, mendojmë ne, duhet trajtuar së pari në pikëpamje teorike, e më pastaj, duke u përcaktuar qartë e saktë termat që do të përdoren, të parashtrohet edhe metoda e punës që do të ndiqet në paraqitjen e argumenteve.”⁷

Më pastaj nisin argumentimet, duke quajtur si problem të parë zgjidhjen e kohës së formimit të gjuhës shqipe. Së fundi parashtrohen disa përfundime, të cilat, për vetë rëndësinë që paraqesin, po i rreshtojmë këtu.

Duke gjykuar që deri në njëfarë mase kemi arritur të ravizojmë mendimin për linjat me të cilat shqipja është formuar si idiomë më vete (shek. V, procesi i formimit vazhdon katër shekuj, I-IV), mendojmë se vetëm kështu mund të nisen përpjekjet për periodizimin e saj.

Së pari përcaktojmë tri periudha të mëdha: *Prehistoria, koha e formimit, historia*.

Prehistoria, i përket gjithsesi nënës së shqipes. Në këtë periudhë dukuritë dalin të përbashkëta me gjuhët e tjera simotra indoevropiane me të cilat grupohet.

Koha e formimit (shek. I-IV). Tipari i përgjithshëm: ndërrimet janë të veçanta e vetëm për gjuhën e re që po formohet në të njëjtat treva nga nëna e saj, ilirishtja.

Historia nis në shek. V. Idioma e re tani mund të emërtohet *shqipja e vjetër*. Që këtu nis periodizimi i gjuhës shqipe.

Historia e gjuhës shqipe ndahet në tri periudha.

⁵ *Rreth historisë ...* 35.

⁶ E. Çabej, SGJ III 36.

⁷ D. Luka, SGJ VII 79.

Periudha e parë ose shqipja e vjetër. Nis në shek. V dhe shkon deri në shek. XIV. Ndahet në dy etapa:

1. **Etapa I**, nga shek. V deri në shek. IX. Tiparet themelore janë trashëgimet e të gjithë nënsistemeve të nënës së saj ilirishte. Ne rreshtojmë këtu të gjitha karakteristikat e kësaj gjuhe të re, të përfutuara në të gjitha nënsistemet përkatëse (fonetikë, morfologji, fjalëformim etj.) me tipar themelor fillimin e ndarjes dialektore të saj.

2. **Etapa II** (shek. X-XIII). Nis me ndikimet e mirëfillta të sllavishtes në gjuhën shqipe, e cila tani paraqitet e konsoliduar në të gjitha nënsistemet. Dukuritë dhe ndërrimet e vjetra nuk gjejnë vend ndër huazimet sllave të shqipes. Ndërkaq procesi i zhvillimit të gjuhës vazhdon normalisht.

Periudha e dytë (ose **shqipja e mesme**) shek. XIV-XVIII. Nis me dokumentimin e shkrimit të saj.

Periudha e tretë (ose **shqipja e sotme**), shek. XIX deri në ditët e sotme.

1. **Etapa I** (1850-1972) paraqet përpjekjen e ndërgjegjshme për konvergencë të të dy dialekteve.

2. **Etapa II** (përk. 1972 e deri më sot) nis me Kongresin e Drejtshkrimit, që sanksionoi njësimin e gjuhës shqipe në të gjitha nënsistemet e saj.

Ky ishte në vija të trasha periodizimi i historisë së gjuhës shqipe, i paraqitur nga ne.

Shkrimi i gjashtë titullohet: “**Vlera e paçmueshme e ‘Mesharit’ të Buzukut për historinë e gjuhës shqipe**”. Aty, ndërmjet të tjerash, shkruhet se “Duke u përkshuar në shtigjet e ngushta e shpeshherë të ngatërruara të historisë së gjuhës shqipe, studiuesit i duhet jo rrallë të ndalet ndër stacione, të pushojë e të marrë fuqi të reja ndër burimet e tyre. Po, stacioni kryesor, ku detyrimisht duhet të ndalesh gjatë, është “Meshari” i Buzukut. Zbulimi i librit qe - në qoftë se mund të shprehem kështu - një revolucion i vërtetë në lëmin e studimeve të historisë së gjuhës shqipe. Siç shprehet E. Çabej, “Në gjuhën e tij (të Buzukut) kemi një burim të pashterur për gjithë degët e albanologjisë”.⁸ Ne tani kemi sjellë në atë shkrim⁹ vetëm një pjesë të këtyre burimeve.

Pjesa e dytë e këtij vëllimi i kushtohet tërësisht **fonetikës historike të gjuhës shqipe**. Këtu ne nuk përkshruajmë, por përpqemi të trajtojmë ato tema që përbëjnë probleme ende të pazgjidhura tërësisht e ku dija e sotme ende nuk ka dhënë përfundime të pranueshme për të gjithë. Qartë shihet kjo aty ku ne do t’u sillemi çështjeve të trajtuara disa herë, duke i rivështruar në të gjitha pamjet që paraqesin. Kështu refleksin e *é*-së së shkurtër e të theksuar indoevropiane në gjuhën shqipe do ta trajtojmë dy herë, guturalet tri herë, po kështu do t’u sillemi disa herë reflekseve të *s* indoevropiane në gjuhën shqipe etj.

⁸ E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, SGJ VI, f. 36.

⁹ Kumtesë e mbajtur në Seminarin XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Tiranë, 16-31 gusht 1995.

Ne kemi botuar gjithsej 28 shkrime të kësaj fushe, të ndara kështu: 9 nga sistemi zanor, 3 nga dukuritë morfonologjike (apofonia, metafoia, kuantiteti) dhe 16 nga sistemi bashkëtingëllor.

Në një artikull, shkruar nga Petrit Kotri e botuar në revistën “Phoenix”, thuhet: “Ajo që të bie në sy në këtë vepër është jo vetëm njohja e thelluar e problemeve të fonetikës historike nga autori, por edhe mënyra e shqyrtimit dhe e argumentimit të çështjeve që trajtohen, duke qenë gjithnjë i motivuar për të dhënë gjykimin dhe vlerësimin e problemit nga pozitat e gjuhësisë së sotme shqiptare, përfshirë dukshëm edhe qëndrimin dhe mendimin e tij shkencor. Me metodën që përdor, duke u nisur së pari nga faktori i brendshëm për njohjen e dukurisë apo të procesit fonetik, e duke kaluar gjithnjë, kur është e nevojshme, në krahasimin e jashtëm të shqipes me gjuhë të tjera, Luka dëshmon profesionalizmin e tij në këtë vepër. Ai ndjehet i sigurt në një fushë që ka hulumtuar prej shumë kohësh, ku edhe ka botuar prej kohësh. Nuk ka qenë aspak e rastit që ai për kontributet e tij në fonetikën historike të shqipes, citohet e përmendet disa herë në veprën “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” të akademikut dhe gjuhëtarit tonë të shquar, Shaban Demiraj, ku madje, në një kapitull të veçantë, siç është ai i rotacizmit, mendimi i tij shtjellohet gjerësisht nga Demiraj, duke e radhitur midis studiuesve dhe dijetarëve më të shquar të kësaj fushe, vendas dhe të huaj.”¹⁰

Në vazhdim, Kotri do të vërë në dukje një tipar kryesor të kësaj vepre: “Është me interes të pohohet se në veprën e tij, ai ka trajtuar kryesisht ato probleme nga fonetika historike e shqipes që vazhdojnë të jenë edhe sot të debatueshme shkencërisht ose të palëvruara gjerësisht”.¹¹

Unë vetë, në *Hyrje* të vëllimit të parë të veprës sime, pata shkruar: “Qëllimi ynë këtu është i dyfishtë. Së pari të trajtohen në fushën e vokalizmit dhe të konsonantizmit në formë monografie probleme që paraqesin interes (për të cilat është shkruar shumë, por nuk është arritur ende një mendim i njësuar) dhe, së dyti, të hidhen hapa përpara për hartimin e një teksti të përgjithshëm (përkrah akademik) ‘Fonetika historike e gjuhës shqipe’, që do të plotësonte një kërkesë të ndjeshme në këtë fushë të dijes e që është vënë re dhe shënuar si nevojë e domosdoshme edhe nga studiues të tjerë.”¹²

Në përmbyllje të artikullit, Kotri shkruan:

“Duke i përmbledhur mendimet dëshiroj të them edhe një herë se ‘Studime gjuhësore V’ e D. Lukës, përbën një vepër me shumë vlerë për fonetikën historike të shqipes. Ajo është një arritje dinjitoze e autorit dhe pasuron më tej veprat dhe kontributet në fushën e gjuhësisë historike. Si e tillë

¹⁰ P. Kotri, “*Studime gjuhësore V*” e prof. David Lukës, vepër me vlerë për fonetikën historike të shqipes, në rev. “Phoenix”, Shkodër, nr. 3-6, 2000, f. 217 v.

¹¹ *Po aty*, f. 218.

¹² D. Luka, SGJ I 68 v.

ajo është e mirëpritur edhe në mjedisin universitar, sepse do të shërbejë si një tekst shumë i vlefshëm i lëndës së fonetikës historike, për leksionet dhe seminarët. Prandaj mund të them se me këtë veprë autori ka nderuar veten, po na ka bërë nder edhe ne të gjithëve. Me këtë libër ai tregoi edhe një herë se bën pjesë në radhë të studiuesve dhe autorëve vendës të palodhur dhe kompetentë dhe me kontribute të shquara në fushën e gjuhësisë së sotme historike. Duke e uruar për këto dy vepra, uroj gjithashtu që vepra si këto të përkthehen në një nga gjuhët perëndimore dhe të botohen edhe jashtë, në mënyrë që libri të fitojë një shpërndarje gjeografike sa më të gjerë edhe jashtë kufijve të hapësirës shqiptarofolëse. Kjo do të ishte në të mirë jo vetëm të autorit, që punon prej 30 vjetësh në këtë fushë të vështirë studimore, por edhe në të mirë të shkencës shqiptare në përgjithësi dhe të gjuhësisë historike në veçanti.”¹³

Në veprën madhore “Fonetika historike e gjuhës shqipe”, Kolec Topalli do ta rreshtojë Lukën ndërmjet atyre gjuhëtarëve që “kanë dhënë kontribute me vlerë”¹⁴ për fonetikën historike të shqipes.

Punimi i parë i kushtohet *theksit në gjuhën shqipe*, i vështruar ky historikisht. Diskutohet këtu për tri probleme. Së pari analizohen dy tipare që në dukje kundërshtojnë njëri-tjetrin: ngulitja e theksit mbi një rrokje të caktuar të fjalës dhe mbeturina të lëvizjes së tij. Vihet në dukje se lëvizja e theksit te tipi *gjárpër gjarpërtinj* (përk. *shtërpínj*) historikisht nuk është lëvizje brenda paradigmes. Pasi bëhet etimologjia e fjalëve përkatese arrihet në përfundimin që prap. *-inj* është përdorur fillimisht për të formuar një njësi të re leksikore, një emër kolektiv. Me kohë kjo prapashtesë u përgjithësua si formant i shumësit te disa lloj emrash. Së dyti, shtrohet problemi se si duhet kuptuar “rregullimi mekanik i theksit” për gjuhën shqipe, i vështruar ky në bashkëlidhje me “ngulitjen e theksit” dhe në kundërvënie me “lëvizjen” e tij. Së treti, për përpjekjet që duhen bërë këtu për të shpjeguar ç’është risi e ç’është e trashëguar nga “nëna” e saj ilirishtja dhe, veçanërisht, kur u shfaqen këto risi.

Në fushën e vokalizmit jepet ndihmesë **“Për refleksin e *é-së* indoevropiane në ja në gjuhën shqipe”**. Në këtë ndërrim mbetet me vlerë në radhë të parë përpjekja për analizën e strukturës fonetike të fjalëve ku shfaqet, i vështruar ky në zhvillimin që ka pësuar gjatë kohëve. Duke gjykuar tani për fjalët ku *é* -ja jep *ja* (të vjelura këto në mënyrë shteruese) vëmë re që ndërrimi i mësipërm shfaqet gjithnjë në formulën *bashkëtingëllore + é + bashkëtingëllore + bashkëtingëllore*. Bashkëtingëllorja e parë e kësaj formule nuk luan rol në këtë ndërrim. Bashkëtingëllorja e fundit mund të jetë pjesë e rrënjës ose shtesë e mëvonshme (relativisht e vjetër). Mbi bazën e bashkëtingëlloreve që pasojnë *e*-në jepen këto renditje fjalësh: *djalë* (nga një rrënjë indoevr. **del-* **dhel-nom*) e *shalë* (**skel-n*); *gjalmë* (**gelm-*) e *pjalm* (**pelm-*); /i/ *djathtë* (nga një bazë e

¹³ P. Kotri, *po aty*, f. 221.

¹⁴ K. Topalli, *Fonetika historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007, f. 6.

mundshme indoevrop. *dek-, çart (*sker-), gjashtë (khs. *seks-), jashtë (khs, p.sh. *eks *eĝh-s), qartë (khs. lat. certe) e mjaltë (*bel/l/-); gjarpër (khs. p.sh. lat. serpens), jam (*esmi) e mbase edhe gjalpë (*selp-) e javë (khs. p.sh. lat. hebdomas); fjalë (*fell- nga zgjerimi i një grupi konsonantik shprehës fl), ngjallë (*engélla *angélla) e qarr (khs. lat. cerrum).¹⁵

Pas analizës së fjalëve të mësipërme arrihet në përfundimin se *é*-ja e shkurtër dhe e theksuar indoevropiane u reflektua në shqipe në *ja* vetëm kur ndodhej para dy bashkëtingëlloreve ose një bashkëtingëlloreje geminante dhe se ky ndërrim është i vjetër, por që ka vazhduar gjatë në gjuhën shqipe, duke qenë në fuqi edhe në periudhën e vonë latine.

20 vjet më vonë do t'i sillemi përsëri këtij problemi me një artikull të botuar në “Buletinin shkencor” të Universitetit të Shkodrës, titulluar **“Edhe një herë për refleksin e *é*-së indoevropiane në ja gjuhën shqipe”**, ku, nëpërmjet një tabele, paraqitet, krahas mendimeve tona, tani të rinovuara, edhe një listë e gjatë shembujsh, për të vërtetuar tezën e parashtruar prej nesh.¹⁶

Në punimin **“Për refleksin e *ó*-së indoevropiane në vo- va- në gjuhën shqipe”** së pari jepen shkurtimeisht mendimet e gjuhëtarëve për problemin në fjalë, duke i vështruar ato edhe me kritikë. Në vazhdim, pasi caktohen disa kushte metodikisht të nevojshme, merren në shqyrtim gjashtë raste: *vodhë vadhë, voj vaj, vorr varr, votër vatër, /i/ vorfën /i/ varfër, /i/ vokët /i/ vakët* ku kundërvënia *vo- va-* shfaqet e padyshimtë nga trajta që në lashtësi nisnin me *Ó*-të shkurtër dhe të theksuar. Me përparësi analizohen ato fjalë (përkat. huazime latine) kur dukuria mund të ndiqet në proces. Së fundi bëhen përpjekje për të shpjeguar shkakun e refleksit të *Ó*-së në *vo- va-* si edhe kohën e kryerjes së këtij ndërrimi. *V*-ja te fjalët që vijnë nga një *Ó*-nistore e theksuar vështrohet me prejardhje dyfishe, më një anë nga një *u-* e dalë nga prirja për diftongimin e *o*-së me zanafillë te format e huazuara nga lat. vulgare, në anën tjetër nga nevoja e konsonantizimit të saj për të lehtësuar shqiptimin e këtyre fjalëve, që përndryshe do të tingëllonin të pazakonta në gjuhën shqipe, e cila nuk ka asnjë fjalë që nis me *ua-*, *ue-* e *uo-*.

Ndërrimi *vo- va-* vështrohet si një ndër elementet e lashta që u ngjizën me formimin e gjuhës shqipe nga “nëna”, ilirishtja, dhe që vërtetojnë lashtësinë e popullit shqiptar në viset ku ky banon që së lashti.

Në vijim rreshtohet edhe një artikull tjetër, po me të njëjtin titull, (**“Edhe një herë për refleksin e *Ó*-së indoevropiane në vo- va- në gjuhën shqipe”**), ku ne polemizojmë me një shkrim të E. Hampit. Shkak për këtë polemikë u bë një artikull me titull “Dy prova leksikore etnobiologjike për përkatësinë e shqipes

¹⁵ BSH, Shkodër, nr. 58, 2008.

¹⁶ Khs. edhe *Scritti in onore di Eric Pratt Hamp (per il suo 90. compleanno)*, Università della Calabria (Italia), 2010, f. 219 v.

në indoeuropeishten e Europës Veriore”, me autor profesorin e nderuar Eric Hamp dhe botuar në një ndër numrat e fundit të revistës “Hylli i dritës”.¹⁷

Profesor E. Hamp, me gjithë moshën e thyer, është sot një ndër personalitetet e fushës së indoevropianishtes. Shkruan shkurt e në mënyrë lakonike; gjithnjë shtron probleme të pazgjidhura deri më tani, ose të diskutueshme, me përpjekjen për t’i zgjidhur, duke dhënë një ndihmesë të rëndësishme në këtë fushë të dijes.

Megjithëkëtë, paraprkishtë ne u detyruam të sqarojmë dy çështje të rëndësishme parimore, gjithnjë në lidhje me shkrimin e sipërpërmendur, në mënyrë që të mos nxisim keqkuptime në të ardhmen.

Në artikullin e sipërhënuar, prof. Hampi, parashtron një çështje që paraqet interes të veçantë për fonetikën historike të shqipes, në veçanti, e më tej edhe për vetë historinë e gjuhës shqipe. Ai, pas një analize të hollësishme arrin në përfundimin se te fjala *vodhë vadhë* e shqipes paraqitet një ndërndërrim (alternim) i *-dh* (δ) fundore në *-ll* (l) dhe anasjelltas. Këtë përfundim e arrin pasi ka hetuar gjeografinë gjuhësore të fjalës nëpër fjalorë të ndryshëm e gjithashtu pas verifikimit të kësaj dukurie në terren. Pas kësaj ai përpilon një tabelë përmbledhëse ku fjala *vodhë vadhë* paraqitet ndër trajtat *vodhë*, por edhe *vollë*, gjithashtu *vadhë* e *vallë* me variante *vollë-viçe*, *mollë-viçe*, *voesë* etj., si edhe *vallë*, *vallëz* etj.

Në vijim unë parashtroj mendimin tim në lidhje me prejardhjen e fjalëve *vodhë vadhë*, dhënë vite më parë, duke mbetur tani edhe pas artikullit të prof. Hampit në të njëjtat pozita, pa luajtur aspak.¹⁸

Në një shkrim të gjatë me titull **“Për refleksin e /ú/-së (së gjatë e të theksuar) : /y/ në gjuhën shqipe”** (Vështrim diakronik), botuar së pari në SGJ XIII, bëhet një analizë e plotë historike e këtij tingulli nëpërmjet etimologjive të fjalëve, ku ky dokumentohet. Interesimi i kaq shumë gjuhëtarëve në zë për refleksin e mësipërm nuk kishte vetëm karakter gjuhësor të mirëfilltë. Refleksi i kësaj /ú/ tani paraqiste interes edhe për historinë e gjuhës shqipe, duke shtuar argumentet për të vërtetuar vendin e formimit të gjuhës shqipe, për kohën e formimit të kësaj gjuhe dhe, veçanërisht për të provuar autoktoninë e popullit shqiptar në viset ku banon që së lashti; e përtej tyre edhe për të dhënë një ndihmesë në periodizimin e historisë së gjuhës shqipe.

Në punë të përcaktimit të kronologjisë së kalimit të /ú/-së së gjatë e të theksuar latine në /y/ në gjuhën shqipe, qoftë në vështrimin absolut të saj, qoftë në atë relativ, ne mbetemi me mendimin e B. Demirajt, i cili pas një analize të plotë, të saktë e të përkryer, ka arritur në këto përfundime: Si *terminus ante quem* do të merret faza e fundit e bjerrjes së korrelacionit të gjatësisë në

¹⁷ “Hylli i dritës”, Shkodër, nr. 3, 2008.

¹⁸ D. Luka, *Për refleksin e /Ó/-së indoevropiane në vo- va- në gjuhën shqipe*, “Studime gjuhësore” V, Shkodër, 1999, f. 26 v.

sistemin zanor të shqipes, ndërsa si *terminus post quem non* ndalimi i dukurisë së metafonisë. Në këndvështrimin kronologjik absolut këta kufij përkojnë me fazën e parë të depërtimit të latinizmave në gjuhën shqipe, në periudhën kur në latinishte nuk qe bjerrë ende korrelacioni i gjatësisë së zanoreve (shek. III pas Krishtit). Gjatë kësaj periudhe latinizmat me /ū/ u pasqyruan me /y/ në shqipe, ndërsa më vonë ato e ruajtën tingullin /u/ të gjuhës burimore.¹⁹ Ndërkaq shembujt që sillen për të vërtetuar këtë kufirin e fundit (*fūsus* : *fishë*, *būbalus* : *buall*, *rūga* : *rrugë*, *rūsculus* : *rrushkull*, *cornūtus* : *kërrutë*) e ndonjë tjetër si *fortūna* : *furtunë*, *mūrus* : *mur* etj. duhen analizuar një e nga një se mos nuk janë huazuar nga lat. klasike, por nga ajo mesjetare (përk. italishtja e vjetër), kur edhe ajo vetë i kishte humbur gjatësitë përkatëse.²⁰ Duke e vendosur në kohë procesin e zhvillimit të /ū/-së së gjatë indoevropiane (ku përfshihet tanimë edhe /ū/-ja latine), tani mund ta vendosim këtë proces edhe në periodizimin që ne i kemi bërë historisë së gjuhës shqipe.²¹ Pra, fonema /y/ është përfutur në gjuhën shqipe në periudhën e kohës së formimit të saj (sipas nesh shek. I-IV); më saktë nga fundi i kësaj periudhe. Zhvillimi i mëtejshëm i saj i takon tani historisë së gjuhës shqipe.

Mendimi që evolucioni /ú/ : /y/ duhet kërkuar që në ilirishtet²², na duket një hipotezë e guximshme, por e pambështetur, veçanërisht gjuhësisht, sa kohë që nuk kemi asgjë të dokumentuar për sistemin fonetik të kësaj gjuhe.

Në shkrimin me titull **“Zhvillimi -o/n/ > -ua, ue në gjuhën shqipe”**, pas një analize paraprake rreth arritjeve të dijes gjuhësore për problemin në fjalë, ne vendosim këto faza, duke përcaktuar edhe kronologjinë e përafërt e të mundshme të këtij zhvillimi.

1. -o/n/ (o-ja e shkurtër ose e gjatë, gjithnjë gojore); zanafilla, koha romake.
2. -ō (-oo gojore e shqiptuar -óo), shek. I-IV.
3. -óü (shek. V-X).
4. -üo (pas vitit 1000).
5. -ua / -ue (shek XIV-XV).

Përcaktimi i një kronologjie pak a shumë të saktë, jo vetëm për dukurinë e diftongimit, po edhe për procese të tjera të fonetikës (përk. fonologjisë) historike të shqipes, bëhet tejet i vështirë e nganjëherë i pamundur, meqë shqipja është e dokumentuar me shkrim mjaft vonë. Megjithëkëtë nuk kanë

¹⁹ B. Demiraj, *Fonema /y/* 118.

²⁰ Për sa më sipër shiko *Fjalorin* e G. Meyerit, *Studimet etimologjike* të E. Çabejt etj., të cilët një pjesë të madhe të fjalëve të rreshtuara më sipër nuk i bien të ardhura nga latinishtja.

²¹ D. Luka, *Periodizimi*, SHGJ.

²² B. Beci, *Rreth evolucionit* 29; aty edhe bibliografia përkatëse (M. Bartoli e G. Restrelli).

munguar përpjekjet për t'i vendosur në kohë dukuritë përkatëse, duke u vështruar këto në sistem e në bashkëlidhje me njëra-tjetrën qoftë me mjetet e brendshme të shqipes, qoftë nëpërmjet krahasimeve me gjuhë të tjera, me të cilat shqipja ka pasur marrëdhënie huazimi.

Në **tri punime të veçanta** janë trajtuar tri dukuri sa të rëndësishme, aq edhe të vështira të fonetikës historike të shqipes.

Te **i pari**, që mban titullin **“Shënime rreth apofonisë në gjuhën shqipe”**, pasi parashtrihen fillimisht studimet e kryera për këtë çështje, sillen shembuj dhe bëhen përpjekje për të vërtetuar se kemi në njërën anë marrëdhënie të raporteve të vjetra apofonike, të cilat as që mund të rindërtohen saktësisht, duke u paraqitur dukuria tejet e vjetër, po edhe e përfunduar mjaft herët; ndërkaq, në anën tjetër, dalin sot përfitime të reja, që pasqyrojnë vetëm gjurmë të apofonisë, sepse paraqesin ndërrime të mëvonshme, që nuk kanë lidhje të dretpërdrejta me të. (Khs. këtu raportet e vjetra *e : o* te **bherō : *bhornā* përballë përfitimeve të reja *bie : barrë* etj.).

Në vazhdim trajtohet edhe refleksi i mundshëm i *schwa secundum*, që në raportet apofonike kuantitative paraqet shkallën zero. Krahas refleksit **e : a*, aty parashtrihet edhe një mundësi tjetër, ajo *e : o* (përkat. *e > ie* dhe *o > a*; raporti i sotëm në shqipe *e/ie/ : a*).

Së fundi bëhen përpjekje për të diktuar shkaqet që përfutuan apofoninë si edhe vendosjen e tyre në kohë, gjithsesi në marrëdhënie edhe me procese të tjera me të cilat ka lidhje.

Te punimi i dytë **“Shënime për metafoninë në gjuhën shqipe”**, pasi paraqiten shkurt studimet e kryera për këtë dukuri, shtrohet problemi i përkufizimit. E. Çabej jep shkallën *a : e : i*, të cilën e emërton “metafoni të zgjeruar” dhe ndërrimin *e : i* e quan “ndërrim vokalik që i afrohet metafonisë”. Sh. Demiraj ndërrimin e parë nuk e merr fare në analizë, ndërsa tjetrin *e : i* e vështron veças dhe pa lidhje me të.

Për arsye metodologjike, për shembujt që merren në analizë e ku shfaqet metafohia, bëhet një lloj klasifikimi. Në vazhdim trajtohet metafohia ndër huazime si edhe përcaktimi i kronologjisë së kësaj dukurie.

Këtu, krahas metafonisë *a : e*, si të tilla trajtohen edhe ndërrimet e mëtejshme (*a*) : *e : i* dhe *e : i*, këta të fundit në bashkëlidhje me shumësin e singularizuar të emrave, i cili, për hir të ruajtjes së sistemit dhe në analogji me ndërrimin origjinal *a : e* (që kryen edhe një funksion morfologjik), vazhdonte si proces i pandërprerë në gjuhën shqipe.

Së fundi nxirren gjashtë përfundime.

1.- Metafohia *a : e* në fillimet e veta kishte karakter thjesht fonetik dhe shfaqej ndër emra e ndër folje. Ajo u shkaktua nga mbaresa indoevropiane *-ī* (e gjatë) e shumësit të emrave si edhe nga mbaresat vetore *-is -it* të foljeve.

2.- Me këtë mënyrë nuk mund të shpjegohet edhe ndërrimi tjetër *o : e*, i cili mbetet i paqartë.

3.- Me rënien e mbaresës $-i$, duke munguar tanimë kushti fonetik, vazhdimi i metafonisë $a : e$, mbetet analogjik.

4.- Ndërrimi i mëtejshëm $/a/ : e : i$ dhe $e : i$ duhen trajtuar në bashkëlidhje me shumësin e singularizuar të emrave i cili, për hir të ruajtjes së sistemit dhe në analogji me ndërrimin origjinal $a : e$ (që kryente edhe një funksion morfologjik), vazhdon si proces i pandërprerë në gjuhën shqipe.

5.- Duke u mbështetur në toponimet ilire që paraqesin apelativa e ku dalin trajtat *trag-* përballë *treg-*, *dal-* përballë *del-*, *dash-* përballë *desh/ar/* themi se metafoia ka nisur herët (rreth shek. I) dhe ka përfunduar kur kishte rënë mbaresa $-i$ (e gjatë), që e shkaktonte atë (rreth shek. IV). Në të mirë të këtij mendimi flasin huazimet latine, ku metafoia paraqitet analogjike, e veçanërisht trajta e fjalës *qen*. Këtu vlen të shënohet gjithashtu se gjatësia e zanoreve në latinisht ishte në shuarje e sipër në shekullin e parë të erës sonë.

6.- Metafoia shfaqet gjithsesi në fjalët vendëse të vjetra, ndër huazimet nga greq. e vjetër dhe ndër shtresat më të vjetra (koha pagane) të huazimeve latine të shqipes. Ndër këto raste ka karakter fonetik të mirëfilltë. Më tej, duke nisur te shtresa më e vonë e huazimeve latine (koha kristiane) e në vazhdim, ajo ka karakter analogjik sekondar.

Në punimin e tretë **“Rreth disa problemeve të kuantitetit të zanoreve në gjuhën shqipe”** (vështrim historik), bëhet një parashtrim i mendimeve të shprehura deri më sot për problemin në fjalë, duke mbajtur edhe një qëndrim kritik ndaj tyre. Problemi kryesor që trajtohet në këtë punim është, së pari, diskutimi nëse kemi apo jo zanore të gjata të hershme (të trashëguara me prejardhje indoevropiane) dhe, së dyti, shqyrtimi i zanoreve të gjata, relativisht më të vona, të përfutuara si përfundim i zhvillimit fonetik që ka pësuar gjuha.

Pasi analizohen hollësisht shembujt përkatës, arrihet në disa përfundime. Ndërmjet të tjerash thuhet se gjatësitë e lashta, që kryenin funksione morfologjike në kundërvënie me zanoret e shkurtra, janë bjerrë të gjitha. Ky proces është kryer kur gjatësia e zanoreve pushoi së qeni jo vetëm si dukuri morfonologjike e mirëfilltë, por edhe si mjet i diferencimit gjuhësor. Koha kur ka ngjarë kjo bjerrje bie gjithsesi para huazimeve latine në shqipet ose në fillimet e tyre.

Në vazhden e kohëve shqipja ka trashëguar disa gjatësi (kryesisht në fjalët njërrrokëshe), por që nuk kanë funksion të mirëfilltë morfologjik dhe nuk paraqiten më si dukuri morfonologjike. Krahas ka përfutur edhe gjatësi të reja, të cilat njësohen me ato pak të trashëguarat në një sistem gjuhësor.

Pas një parashtrimit të dukurisë në fjalë, nxirren këto përfundime:

1.- Gjatësitë e lashta, që kryenin funksione morfologjike në kundërvënie me zanoret e shkurtra, janë bjerrë të gjitha.

2.- Kjo bjerrje është kryer kur gjatësia e zanoreve pushoi së qeni jo vetëm si dukuri morfonologjike e mirëfilltë, por edhe si mjet i diferencimit gjuhësor. Shembull për këtë është kalimi i apofonisë kuantitative në atë

kualitative në gjuhën shqipe. Koha kur ka ngjarë kjo bjerrje bie gjithsesi para huazimeve latine në shqipe ose në fillimet e tyre, sepse zanoret e gjata të latinishtes tani nuk reflektohen më si paraardhëset përkatëse autoktone. Ngjan që një veprim i tillë të jetë kryer në shekujt e parë të epokës sonë (shek. I-IV), atëherë kur edhe gjatësia klasike e zanoreve në latinishte ishte në shuarje e sipër. Kjo periudhë koïncidon edhe me dukuri të tjera, që flasin në të mirë të kohës së formimit të gjuhës shqipe nga “nëna” e saj ilirishtja.

3.- Në vazhdë të kohëve shqipja ka trashëguar disa gjatësi (kryesisht në fjalë njërrrokëshe), por që nuk kanë funksion të mirëfilltë morfologjik dhe nuk paraqiten më si dukuri morfonologjike. Krahas ka përftuar gjatësi të reja, të cilat njësohen me ato pak të trashëguarat në një sistem gjuhësor. Shkaqet themelore të përfutimit të këtyre gjatësive paraqiten komplekse; së pari rënia e bashkëtingëlloreve, por edhe zanoreve (kryesisht *ë*), gjithashtu edhe rënia e një rrokjeje të tërë, që shpesh duhen vështruar së bashku me ndërrime të tjera të njëkohshme si kontraksione zanoresh, monoftongizim etj. E njëjta gjendje dallohet edhe për gjatësitë e sotme ndër të folmet dialektore edhe kur ato janë përfutime krejt të reja.

4.- Krahas shkaqeve të mësipërme, për kuantitetin e zanoreve në gjuhën shqipe duhet pranuar edhe ekzistenca e gjatësive natyrale e pozicionale së bashku edhe me vendin përbrenda fjalisë të fjalës që mbart gjatësinë.

Në artikullin “*Çhundorëzimi i zanoreve të theksuara në gjuhën shqipe*”, pasi bëhet një analizë e gjatë dhe e hollësishme të këtyre rasteve në gjuhën shqipe, arrihet në këto përfundime të rëndësishme:

1. Hundorësia (e bashkë me të edhe çhundorëzimi) nuk janë dukuri të trashëguara, por sipas gjithë gjasës lidhen me zhvillime të brendshme të gjuhës.

2. Hundorësia e zanoreve në gjuhën shqipe në krye të herës është shfaqur vetëm në dialektin gegë, në kohën kur sapo kishin zënë fill dukuritë e para, që në të ardhmen do të dallonin njërin dialekt nga tjetri.

3. Ky proces ngjan të ketë nisur shkallë-shkallë. Së pari duhet të ketë prekur zanoren e ngritjes së ulët /a/ dhe në vazhdim të tjerat.

4. Çhundorëzimi ngjan të jetë më i ri se diftongimi i zanoreve në lidhjet -on -or -oll. Ata ngjajnë të vijnë njëri pas tjetrit: së pari diftongimi në lidhjen -on dhe më pas hundorësia (përkth. çhundorëzimi).

5. Bashkëtingëlloret fundore -n ka rënë gjatë fazës së dytë të zbrërthimit të /-o-/ në diftongun përkatës (o/n/ : ò).

6. Zanorja -o (në lidhjen -on) nuk i është nënshtruar hundorëzimit as në gegërishte, sepse mungonin kushtet për një proces të tillë (zbrërthimi i o-së në diftong dhe rënia e n-së).

7. Rastet e mëvonshme të çhundorëzimit janë kryer përbrenda shqipes në dritën e plotë të historisë, prandaj edhe gjejnë shpjegim me mjetet e saj.

8. Sipas nesh shkaku i parë që i dha shtysë hundorëzimit të zanoreve në gjuhën shqipe, duhet kërkuar te mënyra e nyjëtimit (artikulimit) të këtyre zanoreve në të dy dialektet, që sapo kishin nisur të zinin fill. Në atë pjesë të truallit të shqipes, që më vonë do të përkonte me dialektin gegë, zanoret ngjan të jenë shqiptuar me një ulje të fortë të gjuhës (përk. zanore të ngritjes së ulët). Në pjesën tjetër të këtij trualli (që më vonë do të përkonte me dialektin toskë) ky shqiptim ka qenë disi më i ngritur. Kjo mënyrë e të shqiptuarit të këtyre zanoreve lejon jo vetëm kalime nga hundore (a disi hundore) në orale e anasjelltas, po edhe ndryshime në nyjëtimin e tyre. Dukuri të tilla, kanë ndodhur edhe në frëngjishte, po siç vë re K. Topalli²³, në gjuhën shqipe këto ndërrime janë më të pakta. Me këtë diferencim të mënyrës së nyjëtimin të këtyre zanoreve në toskërishte e në gegërishte, pajton tani edhe mënyra e shqiptimit të *-n-së* ndërzanore, që sipas Pedersenit²⁴, miratuar edhe nga E. Çabej²⁵, paraqitet me një shqiptim të labërguar, të zgjidhur. Pikërisht kjo rrethanë jo e zakonshme e reflektimit të dyfishtë të kësaj bashkëtingëlloreje e detyron Sh. Demirajin të shprehet se "... atëherë duhet pranuar që në kohën e shfaqjes së rotacizmit shqiptimi i /-n-/ ndërzanore në dialektin jugor do të ketë qenë edhe më shumë i labërguar".²⁶ Në këtë situatë lidhja ndërmjet hundorësisë (përk. çhundorëzimit) në gegërishte dhe rotacizmit në toskërishte na ngjan që të jetë e mundshme dhe se këto dy ndërrime (përk. procese) mund të kenë ndikuar te njëri-tjetri. Në të mirë të këtij mendimi flet edhe trajta e sotme e emrit të lumit *Drin* (në geg. *Drî*), që, sipas E. Çabejt është edhe apelativ, në të folët e Dukagjinit "lumë".²⁷

Në shkrimin e gjatë me titull "***Për refleksin -Ó/n/ ~ û në huazimet italiane të gjuhës shqipe***" flitet së pari për vështirësinë e trajtimit të kësaj dukurie. Shkruhet aty se, në studimet për fonetikën historike të gjuhës shqipe, refleksi *-Ó/n/ ~ û* në fjalët e huazuara nga italishtja nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë. Ndërkaq, duke qenë dukuria e mësipërme edhe pjesë përbërëse e proceseve të tjera fonetike (hundorëzimi, rotacizmi, diftongimi etj.), ajo është studiuar shkarazi e në mënyrë anësore me çështjet e trajtuara me të cilat ka lidhje, gjithësesi në mënyrë të ndërsjellë e vetëm për të përforcuar tezat që shtronin artikujt a veprat e botuara për dukuritë që kishin lidhje me të.

²³ K. Topalli, *Për historinë e hundorësisë*, f. 42.

²⁴ H. Pedersen, *Albanesische Texte mit Glossar*, Leipzig, 1895, f. 8 v.

²⁵ E. Çabej, SGJ III 132 ("Fonetikisht rotacizmi i shqipes shpjegohet me mënyrën e shqiptimit të *-n-së* në këtë gjuhë: ky, sikur e vuri re së pari H. Pedersenin është i labërguar, i zgjidhur, dhe kjo si një shqiptim karakteristik i shqipes mbarë").

²⁶ Sh. Demiraj, *Fonologjia* 241.

²⁷ E. Çabej, SE II 320. Për etimologjinë e *Drin-i* shiko edhe D. Luka SGJ I 367 v. Për mungesën e rotacizmit te *Drinos* në Jug të vendit shiko D. Luka SGJ V 158.

Pasi bëhet një analizë etimologjike të fjalëve ku shfaqet kjo dukuri, arrihet në këto përfundime:

1. Refleksi *-Ó/n/ ~ ù* i huazimeve italiane në gjuhën shqipe nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë.

2. Ky refleks pasqyrohet zakonisht ndër huazimet që kanë hyrë nga venecianishtja, kryesisht në gegërishten veriperëndimore, disa herë së bashku edhe me objektet përkatëse.

3. Në analizën e këtyre huazimeve, krahas zhvillimeve në pajtim me fonetikën historike të shqipes, vlen edhe kriteri gjeografik. Këto huazime zakonisht nuk pësojnë shumë ndryshime, në krahasim me simotrat e tyre nga latinishtja, dhe kanë një përhapje më të ngushtë, pikërisht në ato zona që kanë qenë gjithnjë në marrëdhënie me Italinë.

4. Në analizën e huazimeve, për të cilat po flasim, duhen mbajtur parasysh dy përfundime. Së pari ai i prof. Çabejt, që kur analizon fjalën *drangue drangua*, duke kundërshtuar Dh. Kamardën për një lidhje të saj me greq. *δράκων*, thekson: “... mbi të gjitha për arsye morfonematike, nga që *-ua -ue* çon patjetër te një *-on*, dhe theksi i *dragua* pajton me atë të fjalës latine” (SE III 300). Së dyti, mendimi i shprehur nga K. Topalli (*Hundorësia* 38) “... hundorësia dhe diftongimi, për gjuhën shqipe, nuk mund të bashkëjetojnë në të njëjtën fjalë e në të njëjtat kushte; prania e njërës përjashton tjetrën”. Këto janë dy parime bazë kur duhen dalluar huazimet e dyhershme, së pari nga latinishtja, dhe së dyti nga italishtja.

5. Huazimet italiane, që përmbajnë refleksin *-Ó/n/ ~ ù*, kanë hyrë në shqipe me rrugë të ndryshme e në kohë të ndryshme disa herë së bashku edhe me objektin që përfaqësojnë. Duke qenë që pothuajse të gjitha këto fjalë gjenden edhe në gjuhët e tjera fqinje të vendit tonë (kryesisht të Ballkanit) si në sllavishte, rumanishte, greqishte etj., mundësia për t’i analizuar në hapësirë dhe në kohë në përqasje me njëra-tjetrën, na jep dorë që të dallojmë në zhvillimin e tyre edhe dukuritë fonetike përkatëse në proces gjatë kohës e në përputhje me veçoritë e secilës gjuhë përkatëse.

6. Rrugën që kanë ndjekur huazimet nga italishtja (përkat. venecianishtja) e kemi shpjeguar te fjala *cassone* deri te trajta e sotme *kashû-ni*. Së pari duhet thënë se *kashû* e gegërishtes trajtën parësore duhet ta ketë pasur *kasón*, që së bashku me simotrat e saj kanë përfunduar në shqipe me *-û/n/* (nga një *-ó/n/*), si zhvillim i brendshëm i shqipes. Kjo *ó* te *kasón* duhet të jetë shqiptuar disi e buzorëzuar, me timbër më të ulët se *-o* e fjalës nga u huazua, duke dhënë së pari *kas/h/oun* e më pas *kashún* *kashû*. Duke u ndërkallur fjala në sistemin e lakimit të këtyre lloj emrave (në gegërishte), ajo mori përfundimisht trajtën e shquar *kashún-i*, duke u ruajtur tani edhe në njëjës kjo *-n* fundore.

7. Për vendosjen e caqeve të një kronologjie për kohën kur ka vepruar dukuria e hundorësisë në gjuhën shqipe, ne do të mbetemi me mendimin e K.

Topallit (*Hundorësia* 48 v), i cili vë re se dukuria e hundorësisë (bashkë me të edhe rotacizmi), ka vepruar edhe pas shekujve VII-VIII, kur fillojnë marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-sllave; por mungesa e kësaj dukurie në pjesën më të madhe të këtyre huazimeve tregon qartë se me fillimet e këtyre marrëdhënieve ajo është në shuarje e sipër. Në këtë përfundim - shprehet Topalli - të çon edhe analiza e huazimeve nga italishtja, që kanë filluar të depërtojnë në gjuhën shqipe thuajse në të njëjtën kohë me huazimet e hershme të sllavishtes. Prandaj është e natyrshme që kjo dukuri të ketë përfshirë edhe një pjesë të huazimeve nga italishtja; e këtu Topalli rreshton edhe: “*vardū* “një lloj harabeli me ngjyrë të gjelbër” (*Bashkimi* 484; Cordignano, *Alb.-It.* 226) < ital. *verdone* (nga *verde* “i gjelbër”).

Që kjo dukuri ka vazhduar në gegërishte për një kohë të gjatë, e tregon fjala *masū* nga ital. *massone*, e cila padyshim ka hyrë në shqipe në shek. XVIII së bashku me tjetrën *framasū*, të cilat lidhen me lëvizjen e quajtur “Masoneri-a” e “Framasoneri-a”. Huazimet e vona nga italishtja, shumica savante (librore), nuk e paraqesin këtë refleks (përkat. dukurinë -*Ó/n/* ~ *ū*; khs. *bonbon* (ital. *bombone*); *bufon* (ital. *bufone*); *bulon* (ital. *bulone*), *demon* (ital. *demone*); *furgon* (ital. *furgone*), *gomone* (ital. *gommonne*), *tollon* (ital. *tallone*); *tampon* (ital. *tampone*), *tension* (ital. *tensione*) etj..

8. Përshtatja e huazimeve italiane (përkat. veneciane) në fjalorët e shqipes të vitit 1980 e tjetrit 2006, veçanërisht kur aty *ū*-ja e gjatë hundore zëvendësohet me diftongun *ua*, i cili historikisht ka tjetër zhvillim, ka sjellë vetëm ngatërresa. Këto tipe fjalësh, të ndryshuara forcërisht për hir të zbatimit të normës leksikore të standardit, sjellin vetëm çoroditje në analizën e prejardhjes së tyre.

Në **fushën e konsonantizmit** trajtohen *sè pari guturalet*, që përbëjnë një ndër kapitujt më të vështirë të fonetikës historike të shqipes. Duke nisur me G. Meyerin me një vepër kushtuar problemeve të fonetikës historike të shqipes (*Albanesische Studien* III, Wien, 1892) e deri në punimet e këtyre viteve të fundit, çështja shtrohet gjithnjë si e pati shtruar dikur Pedersenin në monografinë e njohur “Die Gutturale im Albanesischen” në vitin 1900. Ky autor ngul këmbë që shqipja është e vetmja gjuhë indoevropiane që i ruan të tri seritë e guturaleve të veçuara në refleksat e tyre. Teorinë e Pedersenit për mënyrën e reflektimit të palataleve indoevropiane E. Çabej e sheh si “të vetmen të drejtë” përkundrejt H. Bariçit, M. La Pianës e V. Pisanit. Edhe për labiovelaret E. Çabej miraton tezën e Pedersenit, ndërsa për trajtimin e deritanishëm të velareve të thjeshta indoevropiane ai mendon se “ka nevojë për një revizion në themel”. Duke përjashtuar postdentalet *s* e *z* nga refleksat e palataleve indoevropiane në gjuhën shqipe, E. Çabej solli një kontribut me vlerë në këtë fushë të dijes.

Ne kemi studiuar *sè pari depalatalizimin* e grykoreve duke arritur në përfundimin që kjo dukuri gjuhësore duhet vështruar në sistemin fonetik të gjuhës shqipe, sepse shfaqet që nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Ky

problem paraqet interes edhe për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe për vendin që zë kjo në rrethin e gjuhëve indoevropiane. Çështja shtrohet për ruajtjen e një *k-je* (përkat. *g-je*), palatale në zanafillë, në grupet *kl gl*, por në raste të veçanta edhe të një *k-je* palatale të mirëfilltë. Problemi vetëm sa është shtruar. Pritet fjalori i ri etimologjik i shqipes për të nxjerrë shembujt e nevojshëm ku të dallohet ç’është konservative dhe e ruajtur që nga lashtësia dhe ç’është përfutur gjatë kohëve, në njërën anë, dhe pse duke qenë e vjetër dukuria, deri tani vetëm e ravizuar lehtë me ndonjë shembull të shkëputur, shfaqet vetëm ndër dialekte e jo në mbarë gjuhën.

Në studimin e asibilimit të palataleve për ne paraqesin interes dy çështje, kur filloi dhe kur përfundoi plotësisht një dukuri e tillë, e në këtë proces, kur u shfaqen spirantet interdentalë të mirëfillta në gjuhën shqipe, të dala prej palatalesh. Duke u mbështetur në disa dëshmi të emrave të defterëve osmanë të shek. XV, ne kemi shfaqur mendimin se dukuria e asibilimit të plotë të palataleve në gjuhën shqipe në toponomastikë ka vazhduar deri në shek. XV. Kjo mundësi shpjegimi zë vend vetëm po të mbajmë parasysh që toponimet u qëndrojnë më shumë ndërrimeve fonetike në atë mënyrë që kur në leksik kanë përfunduar, atje ruhen edhe për një kohë më të gjatë. Kemi të bëjmë me sa duket me përmbjlljen e një procesi, me dukuritë e fundit të tij. Mendimin e sipërm e kundërshton E. Çabej. Në shënimet e lëna për problemin në fjalë në lidhje me artikullin tim “Rreth disa toponimeve të regjistrat turk të vitit 1431” shkruante: “z për *dh* gjan të jetë më fort grafike se fonetike. Procesi z në *dh* kishte marrë fund shumë kohë më parë. Edhe te Fr. Bardhi (1635) gjejmë ndonjëherë z për *dh* si te *zendunë* “prosecare” shq. *me dhendunë*. Ashtu duan gjykuar edhe këto shkrime turke. Te *Burmazi* ne kemi një grafi sllave z për *dh*, sepse sllavët nuk kanë *dh*”. (Letra ruhet nga unë). Fillimisht (në bisedat gojore që kam pasur me E. Çabejn) ai e pati kundërshtuar në mënyrë të prerë mundësinë që z-ja për *dh*-në të jetë fonetike. Pasi u njoh me materialin e plotë të këtyre defterëve (të cilin e pati vështruar gjithnjë me dyshim), ai u lëkund, por ashtu siç e kishte zakon, qëndroi përsëri në të veten. Veçse kësaj herë, siç shihet nga letra, bëri një lëshim të vogël, duke përdorur tani foljen “gjan” e duke lënë disi me dyshim edhe mundësinë e paraqitur prej meje. Natyrisht ne e kemi ngushtuar problemin vetëm ndër toponime, e këtu vetëm ndër defterët kadastralë osmanë të shek. XV. Ky problem, në dukje thjesht fonetik, për rrethanat që paraqesin defterët kadastralë të asaj kohe, përbën një problem me rëndësi për të diktuar shkaku pse *dh*-ja u shkrua si z. Te emrat e regjistrave turq, veçanërisht të atij të vitit 1431 e 1467, mendimi i Çabejt nuk mund të përgjithësohet sepse, siç thamë, aty e kemi të dalluar mirë *dh*-në e z-në. Në këto kushte emrat e regjistrave, që përmbajnë këtë element, do të shkruheshin ose të gjithë me *dh*, ose të gjithë me z. Raste të veçanta me z si element grafik (jo fonetik) do të hidhnin dritë mbi një çështje me rëndësi, për rastet e ndërhyrjeve administrative të të huajve në toponiminë shqiptare, siç e ka vënë në dukje K.

Luka (SF 2, 1975), e kjo kryesisht për defterin e vitit 1485 për shkaqe të cilave u dihet burimi.

Palatalizimin e velareve në sistemin fonetik të gjuhës shqipe ne e shohim si një rregullsi. Veçse këtu jo gjithçka paraqitet e qartë dhe e thjeshtë. Diçka edhe mund të saktësohet, velari në qoftë se ndodhet para një *i* a *j* (kjo vetë nga rrjedha të ndryshme, khs. ndërrimin *kl : kj : q* etj.), ka prirje të palatalizohet. Së pari, duhet të dallohet origjina e *k*-së, e cila mund të rrjedhë jo vetëm nga velari indoevropian, por edhe nga një palatal i depalatalizuar, nga një labiovelar para një zanoreje të mbyllët të cilët, në vazhden e kohëve, u ngjeshën të gjitha në *k* velare. Së dyti, shkaku i palatalizimit dhe, së treti, koha kur u krye ky proces.

Duke arritur në përfundimin se palatalizimi i velareve të thjeshta nuk është as dukuri e rastit, as heterogjene, por një proces i rregullt në sistemin fonetik të shqipes, ne pranojmë së bashku me Pedersenin mundësinë që shqipja të jetë e vetmja gjuhë indoevropiane që i ruan të tri seritë e guturaleve të veçuara në refleksat e tyre. Ky përfundim nuk i bie aspak ndesh mendimit të shprehur nga E. Çabej se palatalizimi i velareve të thjeshta është një dukuri që shfaqet përbrenda gjuhës shqipe në periodën historike dhe shpjegohet me mjetet e saj (metafonia, shumësi i singularizuar etj.). Mendimi i E. Çabejt mund të saktësohet me një shtesë “edhe” (në periodën historike). Kemi këtu më tepër çështje kohe, shembuj që janë interpretuar jo drejt (nga Pedersen p.sh.), por jo mohim të prerë të një dukurie. Edhe në këtë pikë sqarimet do të bëhen të plota kur të kemi në dorë fjalorin etimologjik të shqipes.

Pas dy artikujve të parë, shkruar njëri më 1981 dhe tjetri më 1996, do ta trajtojmë këtë problem edhe në vitin 2008 në një shkrim të gjatë, ku gjithçka tani shohitet duke marrë në konsideratë edhe mendimet e shprehura deri më sot për këtë çështje, të cilat nisin që me gjenezën e tingujve grykorë në gjuhën indoevropiane, duke u bërë krahasime ndërmjet tyre e duke përqasur këtu edhe gjuhën shqipe. Khs. këtu: Pohimi se gjuha indoevropiane në fillimet e veta ka pasur vetëm një seri grykoresh, velaret (prapaqellzoret) e thjeshta, kurse dy seritë e tjera janë përfutur më vonë nëpërmjet rrugëve të ndryshme²⁸, na duket më frytdhënësi në analizën e evoluimit të grykoreve gjatë kohëve. Mënyra e artikulimit të tingujve tek njerëzit, që jetojnë në grupe shoqërore të përbashkëta dhe në kushte të njëjta jetese e zhvillimi, ngjan të jetë në mos e njëjtë, tepër e përafërt. Degëzimet dhe dallimet e këtyre tingujve kushtëzohen tani nga lëvizjet e grupeve të veçanta, të cilët duke jetuar e punuar me lidhje të dobëta me njëri-tjetrin, ose edhe pa lidhje fare, përfutur me rrugë të ndryshme tinguj të rinj, ose modifikojnë ata të vjetrit, gjithsesi për të përballuar emërtimin e dukurive të reja po me fjalë të reja. Në latinishten p.sh. shkronjat *y* dhe *z* iu

²⁸ Khs. O Szemerényi, *Einführung in die vergleichende Sprachwissenschaft*, Darmstadt, 1980, f. 130 v. M. Mayrhofer, *Indogermanische Grammatik I*, Heidelberg, 1986, f. 103 v. K. Topalli, *Mbylltoret* 46.

kanë shtuar alfabetit latin në kohën e Ciceronit (shek. I para Krishtit), ndërsa *u*-ja u dallua nga *v* në mesjetë. Po kështu ka ngjarë edhe me shqipen, ku *y*-ja dhe *ë*-ja janë përfitime të brendshme të vetë gjuhës.²⁹

Pra, fillimisht, kur popujt që emërtohen “indoevropianë” jetonin ende së bashku, për tingujt guturalë ngjan të kishin vetëm një seri, velaret e thjeshta *k* e *g*. Në vazhden e kohëve, duke qenë se këta tinguj tani për nevoja jetësore të ndryshme bashkoheshin me tinguj të tjerë në shqiptimin e fjalëve të reja, lindën seritë e tjera. Së pari, në takimin e *k* (*g*) me *h* u krijuan guturalet aspirative, që sipas nesh do të përfshijnë (përkant. do të përhapen) edhe ndër seritë e tjera, që do të krijohen në vazhdim. Megjithëse sot kjo tezë, që në fillimin e vet që paraqitur së pari prej Brugmannit, është vënë në dyshim këto vitet e fundit, mbetet gjithnjë aktuale. Një pjesë e gjuhëtarëve, që janë marrë me këtë punë, pranojnë një sistem me tri seri burimore, duke përjashtuar në mbylltoret e aspiruara pikërisht ato të pazëshmet³⁰. Mënjanimi i këtij çifti të aspiruar nga seritë përkatëse ka rrjedhë kryesisht për punën se në vazhden e kohëve, duke u pasuar fjala me zanore të ndryshme (të mbyllta dhe të hapta, të gjata dhe të shkurtra etj.), *h*-ja, që shkaktonte aspirimin, ka rënë ose është kontaminuar me tingujt e tjerë që e kanë pasuar atë. Shembull i qartë për këtë është italishtja, që për të dalluar një *ci*- nga tjetra *chi*- vendos aspiratën, që pengon shqiptimin e afrikatës. Shtrirja e aspirimit edhe në seritë e tjera bie në sy sidomos në indishten e vjetër dhe në iranishten e vjetër (avestishten). Ndërkohë në greqishte dhe në latinishte bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të aspiruara janë shndërruar prej kohësh në bashkëtingëllore fërkuese.³¹

Një *kh*-, pasuar nga një zanore e mbyllët, në gjuhën e lashtë shqipe ka përfunduar në *k* velare të thjeshtë. Këtë e vërtetojnë dy shembuj, dy fjalë të shqipes të huazuara nga greq. e vjetër: *λάχανον* dhe *μάχανα*³², që në shqipe kanë dhënë “lakër” dhe “mokër”. Pra një *χ* e greqishtes së vjetër (përkant. dorishtes, nga janë huazuar këto fjalë në shqipe) ka dhënë *k*. Kronologjikisht një *kh*- e pasuar nga një zanore e mbyllët *a* ose *o* në gjuhën shqipe të asaj kohe nuk dilte më e aspiruar. Ajo kishte përfunduar në velare të thjeshtë. Edhe në alfabetin etrusk, të përbërë prej 20 shkronjash (4 zanore e 16 bashkëtingëllore), dilte një *kh* (aspirative).³³

²⁹ D. Luka, *Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe*, “Studime gjuhësore” VII, f. 88, shën. nr. 41.

³⁰ Shiko për sa më sipër Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 38 (shën. nr. 12) dhe f. 48 (shën. nr. 57 me gjithë bibliografi).

³¹ Shiko Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe* 48 v.

³² Vocabolario greco-italiano, dal *Vocabolario greco-tedesco* del professore dott. Carlo Schenkl, tradotto di Francesco Ambrosoli, edizione ottava, Vienna, 1884, f. 561.

³³ E. Sedaj, *Shkrimi alfabetik - zbulim i madh i njerëzimit*, në vëll. “Shqipja arbërore”, Prishtinë, 2002, f. 32.

Ndryshe ngjiste në rastin kur një *kh* (velare e thjeshtë e aspiruar) pasohej nga një zanore e hapët (veçanërisht nga një *i*). Në këtë rast kjo *khⁱ*- prirëj drejt një shqiptimi të palatalizuar. Me gjasë këtu zënë fill tani palatalet e shqipes, të vjetrat e më të rejat (khs. *khⁱ* përballë *kⁱ*), për të cilat do të flasim në vazhdim. Edhe në alfabetin etrusk shënohen qartë bashkëtingëlloret aspirative e, ndërmyet tyre, edhe *khi* për *g* e *phi* për *b*.³⁴

Në rastin kur një *kh* velare e thjeshtë e aspiruar pasohej nga një *v* (*kh^v*-) shqiptimi i saj ndryshonte nga një *k(h)*- e zakonshme, tani duke u mvehtësuar si bashkëtingëllore e re dhe duke u dalluar në alfabetet e ndryshme. Shembull për këtë është alfabeti latin ku bashkëtingëllorja *q* shkruhet *qv*, me gjasë e huazuar nga një *q* etruske.

Jemi në atë fazë ku gjuhët e ndryshme plotësojnë e saktësojnë tingujt me grafema në alfabetet e tyre. Në protoshqipen ngjan që po krijohen nga velaret e thjeshta seritë e tjera, por gjithsesi duke u thjeshtëzuar ato aspirativet. Edhe në vazhden e kohëve bashkëtingëlloret e zanoret që pasojnë grykoret e të tri serive ndikojnë dukshëm në zhvillimin e tyre. Për këtë mjafton të sjellim si shembull depalatalizimin e grykoreve palatale kur ato pasohen nga një *r* (përkat. *r*) ose një *l* (përkat. *l*), për të cilat do të flasim në vazhdim.

Për të pasur një ide të qartë për reflekset e grykoreve indoevropiane në gjuhë të ndryshme, kemi sjellë tabelat përkatëse.

Një shkrim i veçantë u kushtohet edhe reflekseve të mundshme *k > s e g > z* në gjuhën shqipe. Shkak për këtë problem, u bë një libër i Kolec Topallit.

Sh. Demiraj, në veprën e titulluar “Gjuha shqipe dhe historia e saj” do të shprehet se “Mendimi i G. Meyer-it që tektalet qiellzore i.e. në shqipe kanë dhënë jo vetëm *th*, *dh*, por edhe *s*, *z* tashmë është kapërcyer”.³⁵ Shprehjen e sipërme, pa i lëvizur asnjë presje, ai do ta ripërsërisë edhe në veprën tjetër të tij, “Fonologjia historike e gjuhës shqipe”.³⁶

Pikërisht kur ky problem mund të quhej pak a shumë i përfunduar (përkat. i mbyllur), sepse i miratuar nga një numër i madh gjuhëtarësh të vendit dhe të huaj, na vjen pohimi i K. Topallit, në një vepër serioze e të thukët, që u kushtohet mbylltoreve të gjuhës shqipe.³⁷ Ky autor, në kundërshtim me dijetarë

³⁴ *Po aty*, f. 33.

³⁵ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988, f. 39, shën. 17. Shiko edhe shën. 19 ku thuhet: “Për nja trembëdhjetë raste (si *cap*, *plasa*, *sorrë*, *sup*, *zet*, *zog* etj.) Pedersen (f. 337-338) pranon që qiellzoret *K*, *g*, *gh* të kenë dhënë *s*, *z* në gjuhën shqipe. Këtë mendim e kundërshton me të drejtë Çabej në *Hyrje*, 176 si edhe në “Studime filologjike” 1970/2, 82”.

³⁶ Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 183, shën. 11.

³⁷ K. Topalli, *Mbylltoret e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.

të tjerë, u rikthehet përsëri përfundimeve të G. Meyerit.³⁸

Për të vërtetuar se palatali indoevropian *k* reflektohet në shqipe edhe *s* (pra $k > s$) ai sjell dhjetë shembuj, duke bërë edhe analizën etimologjike të tyre (*nesër, përmbys, plas, qas, si /kësi, asi/, so /këso, aso/, sa?, sorrë, sup e sy*). Po kështu për *g* (*gh*) > *z* sjell tetë shembuj: *lëviz, zā / zë, zall, zemër, zet* (në *njëzet*), *zë ~ zura, zog, zorrë*.³⁹

Në këtë shkrim të veçantë, titulluar “**A ka refleksë $k > s$ $g > z$ në gjuhën shqipe**”, botuar në revistën “Studime filologjike”⁴⁰, pasi bëjmë një analizë të imët etimologjike të fjalëve të sjella nga Topalli në mbrojtje të tezës së vet, arrijmë në këto përfundime:

1. Pyetjes nëse a ka në gjuhën shqipe refleksë $k > s$ i jepet kjo përgjigje: ndër katër raste (*qas, sorrë, sup e sy*) mundësia është tepër e madhe; ndër katër rastet e tjera: *nesër, përmbys* (përkat. *mys*), *plas* e *sa* (së bashku me *si* e *so*, që i përkasin të së njëjtës rrënjë indoevropiane), mundësia është e diskutueshme. Për refleksin tjetër $g > z$: ndër katër raste: *lë/viz, zall, /një/zet* e *zë ~ zura* mundësia është tepër e madhe (veçanërisht për *lë/viz* e */një/zet*); ndër katër rastet e tjera: *zemër, zā / zë, zog* e *zorrë* mundësia është e diskutueshme.

2. Ne kemi shprehur mendimin se refleks i $k > s$ mund të paraqesë edhe shkallën ndërmjetëse të një procesi në zhvillim $*k(kh) : /s/ : th$.⁴¹

3. Në qoftë se do të pranohet që ka në gjuhën shqipe edhe refleksë k (g) > s (z), atëherë duhen rishikuar shumë etimologji të gjuhës shqipe, të cilat deri më sot janë shpjeguar ndryshe.

Në shqyrtimin e mënyrës së reflektimit të guturaleve indoevropiane në gjuhën shqipe shkon edhe **grupi *s* + *gutural***, edhe ky një ndër çështjet e vështira të fonetikës historike të shqipes, i rrahur shumë nga gjuhëtarë të ndryshëm duke filluar që nga Dh. Kamarda e deri te E. Çabej. Refleksët e këtij grupi, të komplikuar në vetvete, vinin e vështirësosheshin edhe më tepër edhe për shkaqe subjektive, për vetë mënyrën se si trajtoheshin nga gjuhëtarë të ndryshëm. Asnjëherë nuk u shtrua problemi në tërë pamjen që paraqiste, aq më tepër kur ishte konstatuar se kishim të bënim me refleksë që zinin fill që në lashtësi e vazhdonin gjatë deri në mesjetën e hershme. Duke u vështuar shpeshherë procesi në mënyrë të shkëputur e vetëm me shembuj të veçantë, e

³⁸ *Po aty*, f. 83. “§ 10. Një refleks tjetër i këtij tingulli, siç e vuri në dukje G. Meyerit (AS III 12 v), është fërkimorja e pazëshme /s/, që mund të dëshmohej me rastet e mëposhtme ...”

³⁹ K. Topalli, *Mbylltoret* 91 v.

⁴⁰ “Studime filologjike”, 2003/3-4.

⁴¹ D. Luka, *Për refleksin *s* : *g* në gjuhën shqipe*, në vëllimin *Studime gjuhësore V (Kontribut për fonetikën historike të shqipes)*, Shkodër, 1999, f. 124. D. Luka, *Rreth prejardhjes së emrave Epidamnos - Dyrrhachion*, në vëllimin *Studime gjuhësore VI*, Shkodër, 2001, f. 58 v.

njëta fjalë sillej edhe për të pohuar, por edhe për të mohuar. Kjo edhe pse një numër relativisht i madh toponimesh, të dokumentuara që në lashtësi e që e përmbanin këtë grup, dilnin në shqipen e sotme në forma të ndryshme. Duke mos u analizuar problemi në proces, shpesh shkëputej një fjalë nga leksiku i shqipes dhe krahasohej me toponime përkatëse, pa u vendosur në kohë e pa u shqyrtuar elementet përbërëse të vetë grupit. Krahasohej p.sh. barazimi *Scodra* : *Shkodër* me tjetrin *σκόποδον* : *hudhër* dhe nxirrej përfundimi që për emrin e *Shkodrës* mungon vazhdimësia shqiptare, sepse përndryshe grupi *sk-* i ballit duhej të dilte njëlloj si te *hudhër*. E. Çabej e linte problemin në gjysmë të rrugës kur shprehte mendimin se kjo dukuri "... nuk e prek problemin tonë në pikëpamje kronologjike" (*Kuvendi II*, f. 17). Ashtu siç u gjet një shpjegim i goditur për ruajtjen e grupit *dr* (*Shkodër*) duhej treguar se si kjo *sc-*, duke qenë *Shkodra* qytet i lashtë, arriti deri në kohën antike pa u kthyer në *h*. Shpjegim të veçantë kërkonin edhe emrat *Scupi* (*Shkupi*), *Scampinus* (*Shkumbi*) e veçanërisht *Scardus mons*. Pandërmjetësia e sllavishtes te emri i malit të *Sharit* (*Scardus mons*) dhe zhvillimi i tij nëpërmjet gojës së shqiptarëve për punë të metatezës së likuideve (*skard-* : *skrad-*), që shkon në hulli të gjuhëve sllave, është një shpjegim i goditur e mbushamendës, por puna e refleksit të ballit të fjalës në *sh* përballë toponimeve të tjera në *shk-*, linte përsëri shteg për të diskutuar.

Në shqyrtimin e reflekseve të grupit *s* + gutural në gjuhën shqipe, nëpërmjet një vështrimi të përgjithshëm të problemit, ne jemi përpjekur jo vetëm të bëjmë një parashtrim sa më të plotë të materialit, por edhe ta shkallëzojmë atë në përputhje me refleksat që ky grup ka dhënë në kohë të ndryshme dhe në kushte të veçanta fonetike.

Refleksi i grupit *s* + gutural u shqyrtua tani mbi një bazë më të gjerë e duke u nisur në radhë të parë nga elementet që e përbëjnë atë (*s* e *k*), veçanërisht nga lloji i guturalit në bashkëlidhje edhe me vokalin që e pason, qoftë ky edhe në silabën ndjekëse. Kjo mënyrë e të shqyrtuarit të këtij grupi bëhej e nevojshme (në mos po e domosdoshme) për punë të reflekseve të veçanta të *s*-së e të *k*-së, që në të kaluarën nuk qenë mbajtur parasysht.

Përpjekjet tona për t'i dhënë njëfarë rrugëzgjidhje problemit u përmblohdhën në një skemë ku u pasqyruan refleksat e mundshme të këtij grupi.

I një rëndësie të veçantë është edhe trajtimi i njërit prej *reflekseve të grupit kt në gjuhën shqipe (ct : jt)*.

Problemi i refleksit të grupit *kt* në shqipe, thjesht fonetik në dukje, vjen e vështirësohet veçanërisht nga përpjekja e disa gjuhëtarëve rumunë, të cilët mundohen të japin shpjegime duke u mbështetur në hipotezën e pavërtetuar të një shtegtimi të shqiptarëve prej lindjes në perëndim në një kohë të hershme. Duke shtuar këtu edhe punën që elementi latin i shqipes mban një vend të ndërmjetëm midis romanitetit të lindjes dhe atij të perëndimit (Çabej SGJ IV, f. 290) dhe se shumica e huazimeve latine buron prej asaj forme të veçantë të

latinishtes vulgare që quhet latinishtja ballkanike (Çabej SGJ III, f. 53), në një rënë anë, dhe se elementi latin i shqipes, si për vëllim si për format e tij, është i caktuar të kontribuojë në mënyrë qenësore në sqarimin e çështjes së vendit të formimit të shqipes (Çabej *Problemi*, f. 26), më anë tjetër, kuptohet se problemi i trajtuar i kalon caqet e një studimi thjesht fonetik.

Një grup tjetër studiuesish (Barići, Solta, Weigandi e Pušcariu) janë përpjekur të shpjegojnë shkaku e refleksit të dyfishtë me një “shtresim kronologjik” si valë shtegtimesh (*ct* > *ft* si valë labializuese e ardhur nga Lindja e *ct* > *jt* si valë palatalizimi e ardhur nga Perëndimi), mendime që duhen vështruar me kritikë, sepse këtu tezat shkencore shpesh ndërlikohen me ato nacionalet.

Mendimet e parashtruara nga Bartoli⁴² e V. Pisani⁴³, që shohin te *ct* > *ft* një risi me zanafillë në dialektet e Italisë së Jugut, do të mund të merreshin në konsideratë vetëm pasi të sqaroheshin mirë lidhjet gjenetike midis risive fonetike të shqipes dhe risive fonetike të latinishtes ballkanike. Ndërsa mendimi i K. Sandfeldit⁴⁴ edhe për mundësinë e një substrati, i përsëritur tani në mënyrë të re nga P. di Giovine (“Nuk duket e mundshme që të shtyhem më tej për shkaqet e trajtimit të veçantë të *ct*-së latine në dalmatishte e në shqipe ... veç në qoftë se i sillemi ndonjë rrjedhoje të substratit /ilir, trak ose ndonjë tjetri”⁴⁵), duhet analizuar me kujdes. Ndërsa te Sandfeldi, për vetë nivelin e atëhershëm të studimeve shqiptare, ky mendim edhe mund të pranohej disi, te Di Giovine do vështruar me kritikë, sepse pranimi i kësaj hipoteze të shpie në përfundime largvajtëse, shpesh të gabuara e të papranueshme.

Në vështrimin historik të gjuhës shqipe duhet tashmë të merret në konsideratë domosdo mendimi i E. Çabejt (që në thelb përfaqëson sot mendimin e përgjithshëm të gjuhëtarëve shqiptarë) se “Është metodikisht e gabuar të flitet për një substrat ilir në këtë gjuhë”⁴⁶. Sepse, për të pranuar teorinë e substratit, duhet më parë të vërtetohet që në truallin e shqipes të ketë ndodhur ndërrim gjuhe. Tanimë dihet që teza e vazhdimësisë së shqipes nga ilirishtja është më e qëndrueshme dhe më e argumentuar nga të gjitha tezat e tjera. I vështruar kështu, mendimi i Di Giovines që në shqipe kanë depërtuar e më pas kanë bashkëjetuar dy risi me pikënisje nga dy areale të ndryshme të latinishtes ballkanike, i duhet nënshtruar kritikës. Nuk bëhet fjalë këtu për dy risi, po për dy shtresa huazimesh latine që përmbajnë grupin *ct*, që tani u

⁴² M. Bartoli, *I riflessi di afflare e conflare nell'Italia meridionale*, në “Atti dell'Accademia delle Scienze di Torino” 75, 1939-1940, f. 210 v.

⁴³ V. Pisani, *Geolinguistica e indoeuropea*, Roma, 1940, f. 91 v.

⁴⁴ K. Sandfeld, *Linguistique balkanique*, Paris, 1930, f. 126.

⁴⁵ P. di Giovine, *Il gruppo ...*, po aty, f. 100.

⁴⁶ E. Çabej, *Ilirishtja dhe shqipja*, në vëll. “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve”, Tiranë, 1969, f. 52.

nënshtrohen rregullave fonetike të gjuhës shqipe, e cila është formuar “në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve”⁴⁷.

Dukuria e ndërrimit *ct* : *jt* u studiua nëpërmjet një numri jo të vogël shembujsh: *drejt* (lat. *directum*), te Buzuku si mbiemër *dërejtë*, por edhe si ndajfolje *dëreq*; *pajtoj* (khs. lat. *pactare*); *trajtoj* (khs. lat. *tractare*), por edhe *trajt* (lat. *tractus*) e dëshmuar që te Buzuku; *fryt* (lat. *fructum*); *shenjt* (lat. *sanctum*), te Buzuku *shenjt* (origjinali *segñt*); /i/ *shtrenjtë* (lat. *strinctum*) etj.

Problemet që paraqet refleksi i këtij grupi, duke qenë të shumta e të koklavitura, nuk ndiqen prej nesh në mënyrë statike, të shkëputura nga fjalët ku bëjnë pjesë, sepse në ndërrimet që paraqet, ai vjen e ndërthuret edhe me disa dukuri të tjera të brendshme të shqipes, duke u njësuar me to e duke e bërë tepër të vështirë analizën e procesit.

Duke u përpjekur të dallojmë trajtat e latinishtes vulgare nga kanë hyrë fjalët në gjuhën shqipe që e përmbajnë këtë grup, në njërën anë, gjithashtu të studiojmë grupin *kt* në bashkëlidhje me konsonantet që e përbëjnë e me ndikimin në kohë të njëra-tjetra, veçanërisht të *t*-së mbi *k*-në, në anën tjetër, ne e kemi vështuar ndërrimin *kt* : *jt* jo në vijë të drejtë, por në disa shkallë ku, krahas evoluimit që pëson velarja *k* e latinishtes në gjuhën shqipe, të dallohen edhe ndërrimet e tjera të mëvonshme tani në bashkëlidhje me *t*-në që e pason.

Duke u mbështetur në këto kritere ne kemi arritur në përfundimin që mund të shprehet në skemën *-ct-* (përkat. **-c/i/t-*) : *-qt-* : *jt*. Nuk i nënshtrohen kësaj skeme ato huazime ku nuk dokumentohet shkalla e ndërmjeme *qt*, sepse nuk përjashtohet mundësia që edhe në disa fjalë të latinishtes vulgare të jetë kryer që herët ndërrimi *ct* : *jt* (khs. trajtat e frëngj. *dreit droit*, *trait traiter*, *fruit*, *duit doit*). Një fakt i tillë do të afronte elementet latine të shqipes edhe me latinitetin perëndimor.

Në këtë shkrim bëhen edhe përpjekje për të vendosur në kohë ndërrimin *ct* : *jt* duke e vështuar këtë në kuadrin e përgjithshëm të huazimeve latine të shqipes.

Në punimin me titull “*Kundërvënia e ndërrimit fonetik b- : m- përballë m- : b- në gjuhën shqipe*” ne kemi analizuar ndërrimet përkatëse që kryhen nëpërmjet shkallës ndërmjetëse *mb* me zanafillë të ndryshme. Kemi pra *b-* : /*m/b-* : *m-* dhe *m-* : /*m/b-* : *b-* me një *b-* origjinore të ndërrimi i parë dhe *m-* të i dyti. Tek të dy ndërrimet kemi asimilim, por te i pari progresiv (*mb* : *m*), te i dyti regresiv (*mb* : *b*). Te ndërrimi *b-* : *m-* dokumentohet shkalla ndërmjetëse *mb*, te i dyti vetëm rindërtohet, por qenia e saj mbetet e padyshimtë. Ndërrimi *b-* : *m-* (gjithnjë në ballë të fjalës), veçanërisht te emrat, duket si përfundim i përngjitjes së parafjalës *m-* ndaj një rrënje (përkat. teme) që fillon me *b-*. Shpjegimi i ndërrimit *m-* : *b-* kërkon së pari sqarimin e fjalës rrënjë për të

⁴⁷ E. Çabej, SGJ IV 29.

përcaktuar saktësisht se me çfarë bashkëtingëlloreje nis ajo. Megjithëkëtë, dalja e një *b*-je në grupin *mb*- nuk shpjegohet gjithnjë kënaqshëm. Në rate të caktuara mund të jetë edhe shtesë fonetike homorganike a dialektore. Veçse, si rregull, kjo lloj shtese nuk e asimilon tingullin bazë deri në rënien e tij të plotë.

Dokumentimi i shkallës ndërmjetëse /*m/b*- në ballë të fjalës (te ndërrimi *b*- : *m*) në shkrimet e vjetra të shqipes, por mungesa e tij ndër disa toponime të defterëve kadastralë osmanë të shek. XV, na lejon të vendosim një kronologji pak a shumë të saktë. Ky ndërrim ka nisur që te autorët e vjetër të shqipes dhe vazhdon ndër të folmet dialektore edhe sot e kësaj dite.

Ndërrimi tjetër *m*- : *b*- ngjan të jetë më i vjetër se i pari pasi shkallën ndërmjetëse *m/b*- nuk e takojmë kurrkund te autorët e vjetër. Dukuria në fjalë, pra, ka të ngjarë të jetë mjaft e vjetër a së paku të ketë qenë në fuqi në mesjetë (shek. X). Nuk përjashtohet mundësia që ndër të dy ndërrimet, megjithëse këto i kundërvihen njëri-tjetrit, të ketë vepruar analogjia e në të njëjtën kohë edhe vetë ndikimi i zhvillimit i grupit *mb* në trung e në fund fjale ku shfaqen qoftë rënie tingujsh (*mb* : *m*) ashtu edhe shtesa të tjera (*m* : *mb*).

Në punimin “**Geminantja rr në gjuhën shqipe**” studiohet *rr*-ja në raport me *r*-në, shkaku i forcimit dhe zhvillimit historik të saj. Një ndër tiparet e tingullit *rr* është zëvendësimi i tij me *r* dhe anasjelltas. Kjo dukuri ngjet zakonisht atëherë kur tingulli *rr* nuk ka funksion kuptimdallues, pra nuk e ndryshon kuptimin e fjalës. Këtu nuk është afeksioni që e forcon *r*-në, sepse ajo shqiptohet si e tillë edhe në disa fjalë jo të kësaj natyre, por ose analogjia, ose prirja e një dukurie në formim e sipër, që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Një dukuri e tillë duhet kërkuar në vetë natyrën e gjuhës shqipe, e cila priret t’i shqiptojë fjalët që përmbajnë një *r* (e gjithashtu edhe t’i shkruajë) herë me *rr* e herë me *r*, e kjo që te përmendoret e lashta të shqipes. Te të pesë autorët e vjetër të gjuhës shqipe (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani e te arbëreshët e Italisë, Matrënga) nuk kemi njësi në shkrimin e këtij tingulli. Ne mendojmë se luhatjet e këtyre tingujve (*r* : *rr*) te këta autorë paraqesin gjendjen reale të shqiptimit të tyre. Studimi i pozicionit të kësaj *r*-je si shkak për shqiptimin e fortë të saj, nuk sjell asgjë të re. Këtu nuk ka një rregullsi, sepse aty ku *r*-ja shqiptohet e fortë te një fjalë, në disa të tjera, po në atë pozicion, del si *r*.

Në vështrimin e këtij ndërrimi në zhvillimin e tij historik vihet re mendimi i pranuar nga gjuhëtarët që *r*-ja indoevropiane si tingull më vete ka dhënë *r* dhe vetëm në ballë të fjalës reflektohet si *rr*. Geminantja *rr* (që nga Miklosichi e këtej) është bërë zakon të kërkohet nga asimilimi i grupit *rn*, bile edhe në ato fjalë ku nuk dokumentohet, por vetëm rindërtohet. Numri i shembujve ku *rn* jep *rr* është relativisht i pakët. Ne kemi shtuar këtu edhe dy shembuj të rinj: *shporr* e *harr*. Aty ku grupi *rn* nuk dokumentohet historikisht, ngelet në fuqi mendimi i mprehtë i E. Çabejt që “... unë edhe këtu jam në kundërshtim të prerë me mendimin që ka ekzistuar gjer më sot”. Ai e kërkon këtë dukuri (dhe e provon atë) te geminacioni ekspresiv, që te fjalët afektive *r*-

ja (në pozicione të ndryshme) kthehet në *rr*. Ne kemi shtuar në vargun e shembujve të kësaj dukurie fjalët *shperr*, *sherr* “tredh” e *tjerr*.

Në punë të kronologjisë të asimilimit të *rn* : *rr* mendimi i E. Çabejt që ky ndërrim fonetik ka qenë në fuqi nga viti 1000, po në shek. XVII jo përhera, është plotësuar prej nesh me dëshmitë e defterit turk të vitit 1431.

Në punimin “*Për historinë e zhvillimit të grupit nd në gjuhën shqipe*” ne nisemi nga formulimi i E. Çabejt: “Në kundërshtim me dijen e gjertanishme unë jam i mendimit që grupet e lashta *nt*, *nd* e *ng* në pozicion ndërzonor (intervokalik) pavarësisht nga vendi i theksit përbrenda fjalës, nëpërmjet shkallës *nm* janë asimiluar në *n*, e cila nga puna e karakterit origjinalisht jo ndërzonor të saj, nuk pësoi ndikimin më tej në *r* (rotacizmin) ...” (SF 2, 1970, f. 90). Kësaj rregulle (sipas nesh) i shmangen një numër fjalësh (të cilat janë analizuar me hollësi në punim), ku grupi *nt* është ndërruar deri në *nd* dhe aty procesi është ndalur. Shembujt e analizuar na lejojnë që krahas rregullës së formuluar nga E. Çabejt të vendosim edhe një tjetër, që në disa fjalë të veçanta grupi *nt*, i vjetri, nuk është asimiluar në *n*, por ka arritur në kohën tonë si *nd*, ose të paktën të pranohet si përjashtim i rregullës së përgjithshme.

Edhe mendimi tjetër i E. Çabejt se grupi *nd*, që ka hyrë ose është përfutur në gjuhën shqipe që nga koha romake e këtej, mendohet se u ka ruajtur si i tillë, na duket se duhet rivështruar, eventualisht edhe plotësuar. Për këtë, krahas shembujve nga leksiku i shqipes, kemi shtuar edhe dëshmi të reja nga defterët kadastralë osmanë të shek. XV (1431, 1467 dhe 1485).

Në këtë punim kemi shprehur mendimin që si shkak për ruajtjen e *-n-së* intervokalike në toskërishte pa u rotacizuar mund të pranohet edhe takimi i dy *n-ve* origjinore (një fundore e një prirëse) e me këtë mënyrë ne kemi shpjeguar trajtat e pronorëve *ynë*, *jonë*, *tanë*, *tonë* që paraqiten historikisht si fjalë të përngjitura.

Ndërrimi *s* : *gj* në gjuhën shqipe, studiohet në një punim të veçantë. Ndër katër reflekset e *s-së* indoevropiane në gjuhën shqipe mund të pranohet si i mirëfilltë vetëm *s* : *sh*, i cili nuk kushtëzohet as nga pozicioni i tij në fjalë e as nga bashkëtingëlloret a zanoret që e pasojnë a e paraprijnë.

Ndërrimi *s* : *gj* është kryer përbrenda shqipes gjithsesi nëpërmjet një shkalle ndërmjetëse *sh*, por gjithmonë në prani të një *j-je*, e dalë nga zbërthimi i disa zanoreve në kushte të caktuara fonetike. Kemi pra *s* + vokal : *sj-* (*shj-*) : *gj-*. Ndërrimi *s* : *sh* mund të jetë kryer këtu para zbërthimit të zanores pasuese (me element të parë *j*), ose edhe pas tij. Në mungesë të kësaj *j* (përkat. të zanores që e përfton) ndërrimi nuk kryhet.

Koha e ndërrimit *s* : *gj* është kushtëzuar nga zbërthimi i zanores pasuese (me element të parë *j*). Ka të ngjarë që ky ndërrim të ketë zënë fill herët, por të ketë përfunduar në kohën e vonë latine, sepse nuk na shfaqet në disa huazime të kësaj kohe, megjithëse paraqesin kushte të njëjta fonetike. Ndërrimi i

mëtejme *shj-* : *gj-* është kryer përbrenda shqipes. Për këtë flet qartë edhe puna që në gjuhën shqipe nuk ka asnjë fjalë që nis me *shj*.

Në shkrimin e gjatë me titull **“Spirantja */s/ indoevropiane në gjuhën shqipe”**, së cilës i jemi sjellur disa herë, bëhen përpjekje për të analizuar katër reflekset e mundshme të kësaj spiranteje. Pas një shqyrtimi të imët, arrijmë në këto përfundime:

1. Në inventarin e sistemit bashkëtingëllor të gjuhës shqipe vazhdon qenien e saj një fonemë */s/ indoevropiane (e njësuar në kohë me /s/ të tjera të burimeve të ndryshme, khs. *-tjō > s* përkat. **vratjō > vras*, *lutjō > lus*; *qⁱⁱ/e, i/- > s*, përkat. *penqⁱⁱe- > pesë* etj.).

2. Gjatë zhvillimit historik të gjuhës shqipe, */s/ e ndodhur në kushte fonetike të veçanta, ka pësuar ndryshime, duke dhënë katër reflekse, prej të cilave jo të gjitha janë të dokumentuara në mënyrë bindëse.

- Më i zakonshmi është refleksi */s/ > /sh/, i cili përfshin fjalët e fondit vendës, huazimet nga greq. e vjetër e nga latinishtja dhe vazhdon deri në shek. X (duke përfshirë edhe disa fjalë nga sllav. e vjetër, italishtja e vjetër, përkat. venecianishtja), por jo huazimet më të reja nga sllavishtja, italishtja etj. Në shumicën e rasteve ky ndërrim kryhet pa kushte të veçanta.

- Refleksi */s/ > /gj/ është realizuar nëpërmjet një ndërmjetëse *sh* e ndjekur nga një gjysmë zanore *j*, kjo e përfutur nga zërthimi i një zanoreje tjetër (kryesisht *Ē* e shkurtër dhe e theksuar, para dy bashkëtingëlloreve), khs. skemën *s + vokal : sj-* (*shj-* /*zhj-*) : *gj-*. Ndërrimi *s : sh* mund të jetë kryer këtu para zërthimit të zanores pasuese (me element të parë *j*), ose pas tij. Në mungesë të kësaj *j* (përkat. të zanores që e përfiton), ndërrimi nuk kryhet.

- Për refleksin */s/ > /h/ ngjan mbetet në fuqi mendimi i dhënë nga B. Demiraj se sot për sot është “i pavërtetuar bindshëm”.⁴⁸

- Refleksi */s/ > /th/ ndër dy raste, ku vërtetohet padyshim, është më tepër përfundim i një disimilimi. Në ndonjë rast tjetër *s* (që dha *th*) mund të paraqesë edhe shkallën ndërmjetëse të një palatali të aspiruar *kh*.

Në punimin **“Për historinë e zhvillimit të grupeve *tj* e *dj* në gjuhën shqipe”** arritjes së dijes gjuhësore për grupet e moçme *tj* e *dj*, që në pozicion pastheksor kanë përfunduar në shqipe në *s* e *z* si në fjalët autoktone, si në huazimet latine, i kemi shtuar një shembull të ri, emrin e një krahine (*Prezë-a*), që duket vazhdim i emrit antik *Paretion* (*Baretion*).

Ruajtja e grupit *tj* pa u kthyer në *s* në disa huazime latine (khs. *tjegull* nga lat. *tegula* etj.) është vështuar nga ne jo si refleksi i mirëfilltë i një grupi *tj*, por si zhvillim i brendshëm i një *te-* me diftongimin *e : je*, i kryer ky përbrenda shqipes. Në të mirë të këtij mendimi flasin huazimet latine *kështjellë-a* (lat. *castellum*) e *rashqel* përkat. *rashtjel* (lat. *rastellum*), të cilat pas gjithë gjase i

⁴⁸ B. Demiraj, *Rreth zhvillimit 201*.

përkasin latinishtes së vonë e mbase edhe me ndikim të italishtes. Në vazhdim merret në shqyrtim edhe ndërrimi $tj : q$ (khs. *kështjel* pranë *këshqel* etj.), duke u përcaktuar edhe kufijtë e kësaj dukurie. Për shkakun, kohën e shfaqjes dhe përhapjen territoriale të ndërrimit $tj : q$ (e $dj : gj$), të cilat janë bërë objekt studimi, kemi sjellë mendime e dëshmi të reja.

Një punim i veçantë u kushtohet *shkaqeve dhe kohës së përfutimit dhe të ndalimit të rotacizmit në gjuhën shqipe*. Procesi i rotacizmit paraqitet kompleks, disa herë edhe me dukuri kontradiktore në pamje të parë, që mund të sheshohen me vendosjen e një kronologjie pak a shumë të sigurt. Si në çdo proces edhe te rotacizmi kemi fillimin, zhvillimin intensiv, rënien dhe përfundimin e tij.

Rotacizmi zë fill me ndarjen dialektore të shqipes. Ky është një ndër tiparet më të vjetra të saj që shfaqet në ngjizjen e gjuhës shqipe nga “nëna” e saj ilirishtja. Puna që kjo dukuri përfshin qoftë fjalë të fondit autokton, qoftë huazime nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja, flet në të mirë të mendimit të mësipërm.

Duke mbajtur parasysh shkaqet që përfutuan rotacizmin (fuqia centralizuese e theksit dinamik, rënia e n -së fundore në njëjës të pashquar në raportin emërore : kallëzore, hundorëzimi i zanores pas rënies së n -së në gegërishte dhe mungesa e tij në toskërishte, mungesa në këtë hundorëzim e zanores o etj.) arrijmë në përfundimin se rotacizmi ka nisur në kohën romake ku edhe shfaqet me përqendrimin më të fortë e ku zënë vend edhe dukuritë e mësipërme. Duke i lidhur këto dukuri edhe me metafoninë, që kishte nisur të përfundonte para shek. IV a gjithsesi gjatë tij, vendosja e tyre në kohë kap për afërsisht shek. I-IV të erës sonë. Kjo periudhë, sipas nesh, paraqitet e thukët në ndërrimet cilësore të kalimit nga “nëna” ilirishte te “bija” shqipe. Ndërsa fillimet e rotacizmit duhen kërkuar rreth shek. III, më fuqishëm ai vepron në shek. IV-V, ku merr fund edhe ndikimi intensiv i latinishtes në gjuhën shqipe të sapoformuar. E, siç ngjet zakonisht në kulmin e çdo dukurie, që shënon në të njëjtën kohë edhe fillimin e mohimit të saj, edhe këtu nisin e shfaqen rastet ku n -ja ndërzanore nuk rotacizohet më (khs. *gen*, *liqen*, *mëngë*, *Mingë* etj.). Më pas procesi vazhdon në rënie, po me një shtrirje të madhe në kohë, duke përfunduar ndër toponime në mesjetën e vonë.

Në analizën që i bëhet refleksit $j : z$ në gjuhën shqipe, nxirren këto përfundime:

1. Refleksi $j : z$ është i pranishëm në fonetikën historike të shqipes. Ndërkaq ai duhet studiuar me hollësi duke u nisur jo nga konsiderata të formuara a priori, por nga shembujt përkatës ku ai paraqitet. Përfundimet arbitrare, që kundërshtojnë njëri-tjetrin që në nisje të shqyrtimit të problemit, duhen zbutur; khs. mendimin e E. Çabejt: “Jo palatalet e zëshme indoevropiane kanë dhënë z në shqipe, po z -ja nistore e sotme e shqipes ka dalë nga një j -

nistore indoevropiane.”⁴⁹, përballë atij të K. Topallit: “... janë kërkime që nisin nga mendimi për të vënë një /j/ indoevropiane në bazë të fjalës së shqipes, duke mos pranuar burimin e fërkimores /z/ nga një qiellzore e trashëguar”.⁵⁰

2. Krahasimi i emrit të qytetit (përkat. edhe lumit) *Jader* me *Zadar* (*Zār*) shton një shembull që vërteton qenien e refleksit *j* : *z* në fonetikën historike të shqipes.

Me interes paraqitet edhe shkrimi me titull “*Grupe tri bashkëtingëlloresh ndër disa patronime të gjuhës shqipe.*” Ne jemi përpjekur këtu ta studiojmë dhe analizojmë dukurinë në fjalë në proces, duke dhënë së pari shembujt përkatës e, në vazhdim, duke e shtjelluar problemin në pikëpamje semantike e më pas edhe fonetike.

Shkrimin “*A ka gjurmë laringalesh në gjuhën shqipe*”, që përmbyll pjesën e dytë të këtij vëllimi, ne do ta përfundojmë kështu: Teoria e laringaleve paraqitet gjithnjë joshëse dhe ngjan t’i takojë, në zhvillimin e saj të mëtejshëm, këtij shekulli. Në qoftë se kjo teori do të bëhet në të ardhmen pronë e dijes gjuhësore, ajo edhe në shqipe do të sjellë ndryshime të mëdha në shpjegimin e shumë dukurive të fonetikës historike e më tej edhe të etimologjisë së saj.

Në rindërtimet me laringale indoevropiane, ku përqaset a afrohet edhe shqipja, mendojmë se duhen marrë në konsideratë dy çështje bazë. Së pari, refleksat e zanoreve, të dala nga laringalet, a u nënshtrohen zhvillimeve të mëtejshme dhe në ç’raport janë këto zanore (përkat zhvillime) me zanoret e tjera të barasvlershme me to, por me tjetër prejardhje? Sepse dihet p.sh. se zanorja e sotme /a/ e theksuar mund të ketë (në elementin e trashëguar) shtatë burime; /e/-ja e theksuar nëntë burime etj.⁵¹

Së dyti, në rindërtimin e rrënjëve, saktësia duhet të jetë jo vetëm e madhe, por edhe e përligjur, duke u mënjanuar trajtat e sforcuara.

Rrënja indoevrop. **bher-* (**bhero-*) dihet se reflektohet në shqipe te foljet *bie* (*rashë*) e *bie* (*prura*) dhe te një numër i pafund fjalësh që lidhen me të përbrenda gjuhës. Khs. *bār-i*, *bār* (*baj*), *bari*, *bark*, *barrë*, *ber*, *beronjë*, *bërryl*, *bërrul*, *bjerr*, *borë*, *burrë*, *djerr*, *mbaj*, *mbarë*, *mbarre*, *mbratë* etj.

Përrjashta shqipes me *bie* lidhen a afrohen: ind. e vj. *bhārāmi* (*bhārati*), sanskr. *bhri*, greq. *φέρω*, lat. *fero*, gjerm. e lartë e vjetër *berjan*, got. *baíran*, sllav. e vj. *berŌ bera* (*brati b̄rati*), irl. e vj. *berim* (*biru*), lit. *beriu*. tok. *pār*, arm. *berem* etj.

Në lidhjet *bie* : *barrë* ngjan të kemi gjurmë të apofonisë kualitative *e* : *o* **bhero* > *bie bhornā* > *barrë* (**barnē*).⁵² Khs. edhe *borë* (**bhērā*).⁵³ Po kështu

⁴⁹ SGJ III 145.

⁵⁰ *Mbylltoret* 80.

⁵¹ K. Topalli, *Shndërrime* 259 v.

⁵² D. Luka, SGJ V 32.

⁵³ E. Çabej, SE II 288.

shkallë apofonike paraqesin edhe *bjerr* : *bora*. Ngjan që edhe te *bie* : *prura* kemi gjithashtu shkallë apofonike (khs. *shpie* : *shpura*).

Në shpjegimin e etimologjisë së fjalës *barrë* (përkat. foljes *bie*), ne kemi veçuar trajtën e sanskritishtes *bhri* (e barasvlershme me greq. *φῆρω* e lat. *fero*).

Tani për *bjerr* të shqipes mund të rindërtojmë mbase një indoevrop. **b^h/h₁/er-*, protoshq. **b^her-*, baza për shqipen **biern-* > *bjerr*. Për *borë* indoevrop. **b^he/h₁/re/h₂-*, protoshq. **b^hērā*, baza për shqipen **bēr-*.

Natyrisht, rindërtime të tilla mbeten tepër hipotetike. Për këto raste E. Çabej shprehet: “Shumë herë ndodh që të shtrohet një tezë edhe as miratohet, as hidhet poshtë, se është një gjë e pavërtetuar. Po nganjëherë ndodh që tezat vërtetohen pastaj nga faktet që dalin”.⁵⁴

Pjesa e tretë e vëllimit të gjashtë i kushtohet *gramatikës historike* të gjuhës shqipe. Rreshtohen këtu dy punime.

I pari titullohet “*Për disa krahasime të prapashtesave të ilirishtes me ato të shqipes*”. Në këtë punim, pasi vendosen kriteret e punës mbi të cilat do të mbështetet krahasimi i prapashtesave të ilirishtes me ato të shqipes etj., merren në shqyrtim *-inium* e krahasuar me *-inj*; *-ensi* (*-e/n/sis* *-e/n/ses*) me *-esh*; *-ano* me *-an*; *-etum* me *-et*; *-ot* *-ota* me *-ot*; *-ulo* *-ula* me *-ull*; *-uso* me *-ush* e ndonjë tjetër.

Në shqyrtimin e prapashtesave të këtyre emrave të vjetër dhe në krahasimin me shqipen e sotme duhet të vendosen disa parime që të udhëheqin në punën e metodës. Këtu është fjala nëse ilirishtja i ka të vetat këto prapashtesa, apo i ka të huajtura nga të tjerët dhe si do të veprohet me ato prapashtesa që janë të burimit apo të trashëgimisë indoevropiane, një pjesë e të cilave dalin edhe në gjuhët e tjera fqinje, në latinishte, greqishte e sllavishte. Në këto rrethana operimit me mjete gjuhësore vijnë e i shtohen edhe rrethana të tjera gjeografike-territoriale, historike etj. Pikënisja është koha kur këta emra përmenden nga autorët e vjetër. Që nga ajo kohë e këndeje (të paktën), dija e sotme nuk njih lëvizje a emigracion të ilirëve. Kjo nuk është më vetëm një dëshirë, por edhe një realitet i provuar jo vetëm nga arkeologjia jonë⁵⁵, por edhe e huaja⁵⁶. Nga ana tjetër shqiptarët dalin në po ato treva ku banonin ilirët e jugut, gjuha e tyre është formuar në trevën e sotme gjuhësore⁵⁷ dhe tezat që i

⁵⁴ E. Çabej, SGJ VII 77.

⁵⁵ M. Korkuti, *Rreth formimit të etnosit ilir*, në *Kuvendi I* (v. I), f. 84. S. Islami, H. Ceka *Nouvelles données sur l'antiquité illyrienne en Albanie*, në *Stud. Alb.* Tiranë, 1964, f. 95.

⁵⁶ Konkluzionet e “Simpoziumit mbi përcaktimin e kufijve tokësorë dhe kronologjikë të ilirëve në epokën historike”, mbajtur në Sarajevë, më 1964; *Simpozium* 1964, f. 286-287, sipas A. Benac, *Mbi proceset etnogjenetikë*, në *Kuvendi I* (v. I), f. 128-129, shën. 7. Po kështu A. Benac, *po aty*, f. 133.

⁵⁷ E. Çabej, *Problemi*, në *Kuvendi I* (v. II), f. 26.

bijnë të ardhur janë pa bazë të dokumentuar historike.⁵⁸

Ilirishtja, si gjuhë indoevropiane, ka trashëguar disa prapashtesa. Në këto rrethana është më logjike të mendojmë se shqipja duhet t’i ketë trashëguar këto nga ilirishtja sesa p.sh. t’i ketë marrë nga latinishtja. Prandaj mendimi i shprehur nga C. de Simone se në raportin gjenealogjik të dy gjuhëve prapashtesat që gjenden përveç këtyre edhe në gjuhë të tjera, vështirë të përbëjnë një provë të tillë⁵⁹, në këtë rast na duket i parë mjaft ngushtë.

Krahasimi i prapashtesave të ilirishtes me këto të shqipes duhet të bëhet gjithnjë me dy aspekte themelore, hapësirën dhe kohën. Dihet se prapashtesat e huaja në një gjuhë nuk hyjnë në të ashtu siç janë, por së bashku me fjalët që i përmbajnë ato. Me kohë ato mund të bëhen produktive, duke iu ngjitur edhe temave që janë vendëse. Është e lehtë të dallosh një prapashtesë të tillë kur gjuha që e merr nuk e ka atë. Por, në qoftë se në të dy gjuhët kjo del e njëjtë në formë e në funksion, atëherë për dallimin e prapashtesës së vendit nga ajo e huaja, mjeteve gjuhësore duhet t’u vijnë në ndihmë edhe elemente të tjera.

Ne mendojmë se përparësia, në ato tipe prapashtesash që kanë hyrë së jashtmi dhe janë përzier me formante të vendit (të ngjashme nga trajta e nga funksioni), u përket këtyre të vendit. Prirja e shumë gjuhëtarëve të huaj për të parë në ato vetëm ndikime elementesh të huaja, nuk na duket i drejtë. Fakti që gjuha shqipe u ruajt ndër shekuj, tregon se ajo nuk mund të gjallonte e të zhvillohej me mjete e forma të huaja. Ato, për vetë rrethanat historike e kushtet gjeografike, kanë ndikuar e do të ndikojnë edhe në të ardhmen, por gjithmonë në një masë më të vogël në krahasim me elementet vendëse.

Punimi i dytë, *“Foljet supletive në gjuhën shqipe”*, merr në analizë, duke e vështruar dukurinë historikisht, shkaku dhe kohën e përfuturit të çifteve të foljeve supletive. Pasi bëhet analiza etimologjike e këtyre foljeve, nxirren këto përfundime.

Në gjuhën shqipe me çifte supletive duhen kuptuar dy folje (përkat. tema) rrënjësh të ndryshme.

Temat supletive janë të ndara kështu: njëra shërben për të formuar të kryerën e thjeshtë dhe pjesoren e shkuar dhe tjetra, krejt e ndryshme nga e para, të tashmen. Duke u mbështetur te ky kriter, çiftet e foljeve supletive të mirëfillta në gjuhën shqipe dalin shtatë: *jam - qeshë - qenë, kam - pata - pasur, bie - rashë - rënë, jap - dhashë - dhënë, rri - ndenja - ndenjor, shoh - pashë - parë, vij - erdha - ardhur*. Dy çiftet e tjera: *ha - hëngra - ngrënë* dhe *bie - prura - prurë* nuk i plotësojnë saktësisht e krejtësisht kushtet për t’u quajtur supletive të mirëfillta.

⁵⁸ S. Anamali, *Nga ilirët*, në *Kuvendi I* (v. II), f. 41.

⁵⁹ C. de Simone, *Diskutim mbi kumtesat*, në *Kuvendi I* (v. II), f. 313. Ky mendim kundërshtohet edhe nga V. Pisani, *Përgjigje prof. C. de Simonës*, po aty, 332 dhe M. Domi, *Diskutim*, po aty, 320.

Shkaku i përfutimit të supletivizmit në zanafillën e vet mbetet gjithsesi me dyshim. Mendimi që temat supletive në krye të herës kanë qenë folje të veçanta me kuptime leksikore të afërta, por me vlera aspektive të ndryshme, që me krijimin e sistemit të zgjedhimit u integruan në një paradigmë të përbashkët, mbase mund të jetë i drejtë për disa prej çifteve supletive, por jo për të gjitha. Ky mendim mund të jetë i saktë p.sh. për latinishten (sipas Brugmannit), ndërsa për shqipen nuk mund të përgjithësohet. Qartësohet ky përfundim nga çifti *vij - erdha*, ku folja *vij* është pranuar si e huazuar nga latinishtja. Kuptohet se sado i hershëm të jetë huazimi *vij*, ai nuk mund të futej në një paradigmë zgjedhimi me foljen tjetër *erdha* pa kaluar njëfarë kohe dhe kjo punë mund të ngjiste vetëm në qoftë se kjo dukuri vazhdonte në gjuhën shqipe të asaj periudhe.

Nga kjo del që dukuria e supletivizmit ka nisur herët, por ka vazhduar gjatë në gjuhën shqipe. Ky përfundim mbetet i drejtë edhe në qoftë se te rasti *vij - erdha* kemi formim analogjik.

Vjetërsia e foljeve, që bëjnë pjesë në çiftet supletive, duke qenë ato fjalë të fondit të trashëguar, nuk mund të merret si provë e pakundërshtueshme për të vërtetuar edhe vjetërsinë e dukurisë.

Vëllimi i shtatë dhe **i tetë** u kushtohen tërësisht leksikologjisë dhe leksikografisë së gjuhës shqipe. Jepen në dy vëllime (përkat. në dy libra), thjesht për arsye teknike (të numrit të madh të faqeve).

Në këtë vëllim leksikologjinë e leksikografinë e trajtojmë thjesht si material ndihmës, që do të na shërbejë si mbështetje së pari për studimet tona etimologjike dhe, së dyti, për të nxjerrë përfundime sa më të argumentuara për problemet e drejtshkrimit e të gjuhës standarde, në njërin anë, por edhe për të vënë në dukje kryesisht pasurinë leksikore të autorët gegë, e cila në mos është shpërfillur pa të drejtë nga gjuhësia zyrtare e kohës së komunizmit, është nënvleftësuar e zhvleftësuar pa të drejtë prej saj. Në këtë mes përdoret statistika gjuhësore, që na lejon të nxjerrim përfundime të argumentuara. Vlen të theksohet se në shkrimet e kësaj pjese janë rreshtuar rreth 10 mijë fjalë të rralla, të përzgjedhura nga: *Këngët e Kreshnikëve*, krahina e *Krajës*, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (Gjeçovi), *Prrallat kombtare* (D. Kurti), *Fishta* (*Lahuta e Anzat*), *Palaj*, *Koliqi*, *Camaj*, *Alkaj* e *Malaj*, shumica prej tyre të paregjistruara ndonjëherë në fjalorët e shqipes. Kjo përzgjedhje nuk u bë rastësisht. Ajo shërben në radhë të parë për të konkretizuar dhe materializuar mendimin e shprehur në shkrimin me titull: “A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard?”⁶⁰ veçanërisht në kapitullin ku shpjegohet se si mund të kryhet një punë e tillë.⁶¹

Në këto dy vëllime përfshihen 28 shkrime.

⁶⁰ D. Luka, *A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard?*, SGJ VIII 14 v.

⁶¹ *Po aty*, SGJ VIII 51.

Te **i pari**, “*Elementet e reja të leksikut në gjuhën shqipe*”, shqyrtohet përzjerja (shartimi a kryqëzimi) i dy fjalëve. Në ndjenjën gjuhësore të popullit, kryesisht në fushën dialektore, për shkaqe nga më të ndryshmet, një fjalë shartohet me një tjetër duke formuar kështu një fjalë të re. Studimi i këtyre elementeve na hap pamje edhe për të përcaktuar më saktësisht peshën që ka mendësia popullore në formimin e fjalëve të reja, veçanërisht për rolin aktiv të saj në pasurimin e leksikut me fjalë të reja nga lënda gjuhësore ekzistuese, duke i përpunuar me mjeshtri nëpërmjet etimologjisë popullore. Me këtë rrugë gjejnë shpjegim disa fjalë e forma që deri tani kanë ngelur të paqarta, ose edhe janë shpjeguar jo drejt. Këto elemente ndërkaq janë pjellë e zhvillimit të brendshëm të gjuhës dhe duhen rreshtuar në fondin themelor të leksikut të saj.

Në punimin e dytë, “*Lentimet leksikore elementare në gjuhën shqipe*”, bëhen përpjekje për të trajtuar një ndër mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, leksikalizimin e disa grupeve konsonantike shprehëse, të cilat janë quajtur “fjalë figurative” ose “lentime (krijime) leksikore elementare”. Në punim bëhen përpjekje për të sqaruar rrugën e formimit të këtyre fjalëve, për shkaqet që e përfatuan këtë formim, për marrëdhëniet ndërmjet afrisë elementare dhe asaj gjenealogjike, për të shpjeguar përse këta “rrënjorë” (= grupet konsonantike fillestare) janë “shprehëse”, me ç’mënyrë zgjerohen dhe se ndër këto “formime spontane” ku qëndron e përbashkëta dhe e veçanta të secila gjuhë disa herë edhe gjenealogjiksht, edhe gjeografiksht të largëta nga njëra-tjetra. Sepse të pranohet që kemi formime spontane pa shkak, kjo do të thotë të mënjanojë mundësinë e një shpjegimi.

Problemi i rrugës së formimit të këtyre fjalëve, i shkaqeve që e përfatuan këtë formim, nuk është edhe aq i thjeshtë për t’u zgjidhur. Fjalë që kanë për bazë një grup konsonantik shprehës ndeshen edhe ndër gjuhë të tjera. Kjo të detyron të bësh një lloj analize për të vështruar se në ç’marrëdhënie ndodhet “afria elementare” me atë “gjenalogjiken” dhe a e përjashtojnë këto njëra-tjetrën, pra a mund të vendosen këtu për raste të caktuara edhe marrëdhënie huazimi.

Pa mëtimin se po japim një zgjidhje të plotë e përfundimtare, ne vetëm e shtrojmë problemin me përpjekjen për të hapur shtigje të reja në studimin e prejardhjes së disa fjalëve në gjuhën shqipe.

Punimi **i tretë** me titull “*Shtegtimi i fjalëve*” merr në analizë fjalën *pogaçë-a*. Jepet mendimi se *pogaçë* është e përhapur kryesisht ndër ato krahina veriore të Shqipërisë që qëndruan për një kohë të gjatë nën sundimin e feudalëve serbë të shtetit të Dioklesë e të Rashës (shek. XI-XIV). Është pikërisht kjo kohë kur fjala hyri në këto treva fillimisht si *focacia*, në shqipe përfundoi *fugacë* e në serbokroatishte *pogača*. Nga fundi i kësaj periudhe, fjala, nën trajtën serbe, hyri në krahinat shqiptare si *pogaçë*, me gjasë së bashku me objektin që emëronte.

Prejardhja e fjalës *pogaçë* në gjuhën shqipe flet në të mirë të mendimit se huazimet sllave të shqipes, këto për një pjesë të mirë, kanë mbetur të kufizuara në krahina të veçanta të vendit.⁶²

Shtegtimi i fjalëve nga një gjuhë tek një gjuhë tjetër, zakonisht është i kushtëzuar nga marrëdhëniet që kanë vendosur gjatë kohëve popujt që i flasin a që i kanë folur këto gjuhë.

Për gjuhën shqipe studimi i këtyre fjalëve paraqet interes të veçantë për disa arsye. Shqipja, megjithëse është një ndër gjuhët më të vjetra të Gadishullit Ballkanik, dokumentohet me shkrim mjaft vonë. Në fondin e përgjithshëm të leksikut të shqipes mbizotëron elementi i huaj përballë elementit vendës, në një kohë kur në strukturë ajo ka ruajtur individualitetin dhe origjinalitetin e saj si një gjuhë e mirëfilltë indoevropiane me tipare të përcaktuara qartë.

Formimi i popullit shqiptar, i gjuhës dhe i kulturës së tij, nuk del i plotë në dritën e historisë për “*ex silentio*”, megjithëse ai u formua në këto troje, ku vazhdon jetën e vet shumëshekullore.

Në këtë situatë studimi i elementeve të huaja në brumin vetjak të leksikut të shqipes është me dobi jo vetëm për të pasqyruar marrëdhëniet e kësaj gjuhe me gjuhët e tjera, por edhe për të njohur më thellë marrëdhëniet e popullit shqiptar me popujt fqinj.

Fjala e huazuar ruan “kombësinë” nga ka ardhur, por në të njëjtën kohë merr “nënshtetësinë” e gjuhës ku vendoset, duke iu nënshtuar aty të gjitha rregullave përkatëse gramatikore.

Hetimi i këtyre lidhjeve gjuhësore në sistem shërben jo vetëm për të dalluar ndërrimet që ajo ka pësuar gjatë shtegtimit nga një gjuhë tek tjetra, por edhe për të gjykuar me saktësi për kohën kur ajo u huazua e, përtej kësaj, edhe për të hedhur dritë për marrëdhëniet që përfaqësohen nga një grup fjalësh të një sferë sociale të caktuar.

Dihet se elementi sllav i huazuar përfshin sfera të ndryshme të veprimtarisë së njeriut, duke mbizotëruar ndikimi në fushën e kulturës materiale e të ekonomisë shtëpiake, sidomos në bujqësi dhe më pak në blegtori. Veçse këtu duhen vënë re dy fakte me rëndësi, që ato nuk janë përherë të vjetra, duke u lidhur shpesh me pushtimet sllave⁶³ dhe se për shumë huazime sllave të kësaj natyre shqipja ka fjalë burimesh të tjera (khs. p.sh. krahinën e Krujës, ku për sllav. *lesë* ka *trinë, trenë*; për *brazdë* ka *hullí, vijë, tranë* “hullí e gjatë”; për *prashit* ka *mih, capoj*; për *vadit* ka *ujit, ujttoj* etj.).

⁶² E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, I, Tiranë 1982, f. 128.

⁶³ A. Buda, *Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij*, në rev. “Studime historike”, 1980/1, f. 171.

Kultura popullore shqiptare edhe në të kaluarën ka pasur si karakter urban ashtu edhe fshatar⁶⁴ dhe përfundimet e kundërta⁶⁵ nuk i qëndrojnë dot kritikës.

Punimi i katërt titullohet “*Ndihmesa e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*”. Për të vënë në dukje pasurinë leksikore të Lahutës, e në të njëjtën kohë edhe ndihmesën e Fishtës në pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe, jemi nisur nga botimi i vitit 1997 (ribotim i vitit 1937), prej ku kemi përzgjedhur 500 fjalë të rralla, 55 kompozita si edhe një numër fjalësh, që janë përdorur me kuptime të reja nga ato të zakonshmet. Më pas kemi ndjekur daljen e këtyre fjalëve ndër fjalorë të ndryshëm, duke nisur nga G. Meyeri e deri te *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, të cilat i kemi rreshtuar kronologjikisht sipas një tablele. Statistika tani ndihmon për të përcaktuar ndihmesën e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe.

Studimi dhe analiza e fjalëve të rralla, nxjerrë nga vepra “*Krijimtari gojore (Krajë - Malësi)*” e patër Zef Jankaj, paraqiste interes të veçantë, sepse te kjo e folme ruhen ende trajta të vjetra të dukurive gjuhësore, që në disa raste përkojnë me gjuhën e përdorur nga Buzuku te “Meshari” dhe, në anën tjetër, takonin disa herë edhe me trajtat e dialektit toskë. Punimi paraprihet nga një hyrje, që ndiqet nga fjalori i vjelur nga kjo vepër.

Në vazhdim kemi analizuar “*Këngët e kreshnikëve*”. Problemet që shtrohen në *Hyrjen*, që paraprin *Fjalorin*, janë të shumta e të shumëllojshme, disa herë edhe të karakterit kombëtar. Në përmbyllje thuhet: Në përfundim të kësaj *Hyrjeje* e shoh të arsyeshme të vë në dukje se qëllimi i punimit tim nuk ka qenë vetëm vjelja e leksikut të ciklit të këngëve të kreshnikëve. Përkundrazi, qëllimi i vërtetë i këtij punimi ka qenë vënia në dispozicion studiuesve të ardhshëm të një materiali brut, tani të vjelë e të përpunuar sipas kritereve filologjike.

Deri më tani, me sa dimë ne, nuk është bërë një punë e tillë gjithëpërfshirëse. Është thënë e folur shumë herë për pasurinë e madhe gjuhësore që përmban *Eposi i Veriut*; për shumëllojshmërinë e problemeve që ai fsheh në vargjet e veta, për rëndësinë e tij për të shpjeguar jo vetëm shpirtin shqiptar të hershëm, *ADN*-në e tij, po askush nuk është shtruar asnjëherë ta bëjë objekt të studimeve të veta.

Pas mbledhjes dhe parashtrimit të krejt materialit përkatës, jam munduar të jap edhe unë konsideratat e mia për shumë probleme, çështje e pyetje të pazgjidhura, gjithnjë duke u mbështetur vetëm ndër të dhënat që jep leksiku i mbledhur dhe i shpjeguar këtu.

⁶⁴ E. Çabej, *Disa aspekte të kulturës popullore shqiptare në vështrimin gjuhësor*, në rev. “*Studime filologjike*”, 1977/2, f. 24-26.

⁶⁵ A. M. Селищев, *Славянское население в Албании*, София, 1931. I. Popović, *Elemente vendëse në fjalorin e gjuhës shqipe*, në “*Përparimi*”, nr. 2, 1956.

Gjithashtu jam përpjekur të pasqyroj me shembuj përkatës edhe rrezatimin e këtij leksiku tek dy autorë të mëdhenj të letërsisë shqipe (Fishta e Alkaj), veprat e të cilëve trajtojnë të njëjtat tema.

Me rëndësi është nxjerrja e trajtimi nga leksiku i këngëve të kreshnikëve edhe i huazimeve nga turqishtja e nga sllavishtja, analiza e tyre veç e veç dhe raporti në mes tyre. Natyrisht këto huazime flasin në të njëjtën kohë edhe për raportet sociale e historike të shqiptarëve me turqit e me sllavët.

Në fundin e punimit kemi analizuar rreth 110 fjalë, duke u munduar të japim fjalët e reja, të cilat nuk ndeshen në fjalorët e shqipes së sotme. Gjithashtu, aty ku e kemi parë të nevojshme, kemi bërë edhe historinë e disa fjalëve, që paraqesin interes për gjuhën shqipe. Kjo punë do t'u shërbejë veçanërisht studiuesve të rinj për t'u orientuar drejt në studimet e tyre të ardhshme.

Punimi ndahet në dy pjesë. Së pari vjen *Hyrja*, ku parashtrojmë mendimet tona në lidhje me problemet e këngëve të kreshnikëve, por gjithsesi të lidhura me leksikun e nxjerrë prej nesh. Më pastaj, *Fjalori*, ku analizohen fjalët e vjela, duke u shënuar numri i faqes, ku del fjala, zberthimi i saj si edhe vargu ku ndodhet ajo, duke bërë disa herë edhe krahasime me këngët e krahinës së Rugovës. Ndër shënimet nën vijë janë dhënë shpjegimet përkatëse për secilën fjalë.

Shpresoj që puna e kryer në këtë vepër të shërbejë si nxitje për studime të mëtejme e më të thelluara për ciklin e këngëve të kreshnikëve, gjithnjë me dobi për pasurimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe. Sepse, me sa kam vënë re deri më tani, kemi ende mjaft gjëra për të mësuar nga trashëgimia kulturore kombëtare.

Për të përligjur katër artikujt, të përfshirë në këta libra (*1. Fjalor i fjalëve të rralla në veprën poetike të Bernardin Palajt*; *2. Fjalorth i fjalëve të rralla në veprën e E. Koliqit "Pasqyrat e Narçizit"*; *3. Fjalor i fjalëve të rralla në prozën "Pishtarët e natës" të Martin Camajt*, si edhe *4. Fjalor i fjalëve të rralla në veprën "Anzat e parnasit" të Gjergj Fishtës*), jepen shpjegimet përkatëse, që paraprijnë shkrimet e sipërpërmendura.

Për ndërkaljen në këtë pjesë të shkrimit me titull "***Kush bân tllar, des s'oi javë!***", jepen këto shpjegime: Tregimi i sipërm, i shkruar në të folmen e Dukagjinit, është botuar së pari në gazetën "Tomori" më 11 tetor 1942 nga atë Bernardin Palaj.⁶⁶ Ky shkrim, duke pasur për autor një njeri të ditur, paraqet interes të veçantë për dialektologjinë shqiptare. Autori me mjeshtëri ka dhënë

⁶⁶ Atë Bernardin Palaj ka lindur në Shllak (Shkodër) më 1894 dhe ka vdekur nga torturat çnjerëzore në një burg komunist në Shkodër më 1947. Ka një veprimtari të dendur intelektuale dhe një prodhimtari të bollshme si folklorist, etnograf, shkrimtar, muzikolog, gjuhëtar, dialektolog etj. (Shiko për sa më lart A. Çapaliku, *Bernardin Palaj /Jeta dhe veprat/*, Monografi, Shkodër, 1999).

në formën e një tregimi tepër të arritur artistikisht, strukturën e të folmes së Dukagjinit. Gjithashtu, ai ka përdorur një leksik tejet të pasur, me fjalë e shprehje, që sot, në disa raste kanë humbur e nuk dëgjojen më, por që janë burim për pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe, veçanërisht me kuptimet e reja që paraqesin në të folmen e Dukagjinit.

Tregimi, i përgatitur për botim prej nesh, ka ruajtur të paprekur origjinalin, duke ndrequr vetëm gabimet e shtypit. Gjithashtu kam dhënë edhe shpjegimet përkatëse për kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të rralla, që në shumicën e rasteve nuk dalin në fjalorët e sotëm. Për një pjesë të madhe të shpjegimeve jam konsultuar edhe me banorë të Dukagjinit, duke e bërë tekstin tërësisht të kuptueshëm dhe duke u hapur rrugë studiuesve të rinj për hulumtime të mëtejshme leksikografike e dialektologjike.

Në vazhdim rreshtohet edhe shkrimi me titull **“Fjala e rrallë në përmbledhjen poetike “Papërdhokë e gurë faqokë”** të patër Vinçenc Malaj, një ndihmesë e vyer për pasurimin e fjalorit të gjuhës shqipe.

Me rastin e 10-vjetorit të vdekjes së patër Vinçenc Malaj, sivëllezërit e tij, fretërit e Tuzit, kishin vendosur, ndërmjet të tjerash, të botonin edhe poezitë e këtij të fundit, të cilat, ai vetë, nuk i pati botuar me gjallje të tij. Poezitë e sipërme qenë të shpërndara në revista të ndryshme. Një pjesë u gjetën edhe në dorëshkrimet e tij. Fretërit e Tuzit i mblodhën me kujdesin më të madh dhe i kaluan në printer (kompjuter). Duke ditur për miqësinë e madhe që unë kisha me patër Vinkon (siç e quanim ne miqtë e tij), ata m’u drejtuan mua me kërkesën që të bëja redaktimin e veprës. Natyrisht unë pranova me kënaqësi. Por u ndodha menjëherë para një vështirësie jo të zakonshme. Së pari, jo gjithnjë kisha përpara tekstin origjinal (përkate dorëshkrimin) e autorit, kryesisht për vjershat e botuara. Por, edhe për ato të pabotuarat, shpesh pata përpara jo origjinalin, po kopjen e printuar nga fretërit. Duke ditur se patër Vinkoja ishte specialist gjuhësie (ai mbante gradën shkencore “doktor” shkencash), unë e kisha të vështirë të dalloja se ku ai mund të ishte i pasaktë në shkrim, e ku jo, pra ku duhej ruajtur trajta origjinale e fjalës. Ngjante që ai të kishte mbledhur fjalët e vjetra të krahinës ku jetonte dhe këto, tani pak a aspak të përdorura, t’i kishte ndërkallur në poezitë e veta. Meqë koha nuk priste, unë bëra atë sa munda për redaktimin e poezive dhe, për të mos penguar lexuesin, për çdo vjershë, vura poshtë saj ndër shënime edhe shpjegimin e atyre fjalëve, që munda t’ua nxirrja kuptimin. Kur u botua vepra, vura re se shtypshkronja kishte rifaqosur veprën, duke i ndërruar formatin, duke shtuar fotografi etj. Me këtë rast kishte prekur shënimet, të cilat, jashtë çdo rregulle, i kishte vënë në fund të vëllimit, jo në trajtën që kërkonte një përmbledhje e tillë. Tani me rastin e botimit të veprës sime, mendova që këtë pasaktësi të paqëllimshme, ta ndreq. Ky ishte njëri shkak. Më pas unë bëra shpjegimin e plotë të krejt fjalëve të rralla, sepse m’u dukën me interes të madh për fjalorin e gjuhës shqipe, duke sjellë tani fjalë krejtësisht të panjohura e të paregjistruara më parë, të cilat nuk i

përdorte më askush as në krahinën ku qenë mbledhur, e cila ndodhej jashtë kufijve administrativë të Shqipërisë. Në disa raste jam detyruar të jap shpjegime të përafërta, duke ua lënë të tjerëve që të bëjnë hulumtime më thella për to. Them kështu, sepse përveç disa fjalëve, që duken nga larg se janë perla popullore, gjithësi të pazbuluara, aq më tepër kur një pjesë e madhe prej tyre emërtojnë përdorëse (vegla) të punës së përditshme të banorëve vendës shqiptarë të atyre anëve, përballemi edhe me neologjizma të krijuara nga vetë autori, fjalë të përbëra etj., që ua shtojnë tej e tej vlerën atyre. Mjafton të vështrijmë në një rën nga fotografitë e paraqitura në këtë vëllim për të ashtuquajturin “koshi i spikut”, një tezgjah popullor i paparë e i pastudiuar deri më sot për pasurinë e madhe të leksikut të gjuhës shqipe, për t’u bindur sa thashë më sipër.

Një vend të veçantë i kemi lënë “*Magjia e fjalës te vepra ‘Lahuta e Malcís’ e atë Gjergj Fishtës*”⁶⁷, ku rreshtojmë dy shkrime.

I pari, “*Lahuta e Malcís*” e atë Gjergj Fishtës, një ndër kryeveprat e papërsëritshme të letërsisë shqipe”, rreh të trajtojë fatet e kësaj vepre nga viti 1937, kur pa dritën e botimit, e deri në ditët e sotme, së bashku me vlerat e saj, veçanërisht në fushën e leksikut. Trajtohen këtu tri periudha të qenies së saj: *periudha e parë* (1937-1944); *periudha e dytë* (1945-1990) dhe, *e treta* (1990 deri më sot).

Në vazhdim, në formë kapitujsh të veçantë, trajtohen çështje që kanë lidhje me leximin dhe konceptimin e *Lahutës*. Pasonjë kapitujt që shtrojnë probleme për gjuhën e saj, se si duhej shkruar *Lahuta* dhe, më tej, nëse mund të tjetërsohet ajo. Analizohet këtu leksiku tejet i pasur i veprës, duke parashtruar mendimet e atyre që kanë shkruar më parë për këtë problem, por duke u bërë gjithësi vërejtjet përkatëse.

Në një kapitull të veçantë, titulluar *Fishta dhe standardi*, thuhet se ballafaqimi i gjuhës së veprave të Gjergj Fishtës me *standardin*, nuk është vetëm problem i Fishtës, po i gjithë gegërishtes (duke përfshirë këtu edhe *Eposin e Kreshnikëve*). Po në këtë vijë paraqitet edhe kapitulli, që pason, me titull “*Fishta për gjuhën e përbashkët letrare shqipe*”, ku thuhet: “Fishta, në shënimet për veprën e Asdrenit, parashtrroi teorinë e vet për gjuhën e njësuar a të përbashkët, siç e quante ai. Nuk besoj të ketë këtu as *qëndrim armiqësor*, as *keqdashje* e as *kundërshtime* për gjuhën e përbashkët. Ndërsa rruga që duhej ndjekur për ta realizuar këtë njësim, ishte diçka tjetër.” Në vazhdim do ta trajtojmë këtë problem më hollësisht te shkrimi “*Pikëpamjet e Gjergj Fishtës për gjuhën e përbashkët letrare shqipe*”.

Vend kryesor në këtë studim zë analiza filologjike e semantike e fjalorit të *Lahutës*. Qëllimi ynë ka qenë i disafishtë. **Së pari**, të paraqesim të gjithë

⁶⁷ D. Luka, *Magjia e fjalës te vepra “Lahuta e Malcís” e atë Gjergj Fishtës*, “Studime gjuhësore” XIV, Shkodër, 2012.

pasurinë leksikore të fjalëve të rralla në këtë vepër, tani jo më me hamendje, por të shtjelluara me hollësi. **Së dyti**, të parashtrijmë ndihmesën e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe, punë që deri më tani nuk ka qenë e përcaktuar sa e si duhet. **Së treti**, të dallojmë neologjizmat e përdorura në këtë vepër. **Së katërti**, të vëmë në dukje edhe intensitetin e përdorimit të fjalëve, punë që nuk mund të bëhej në mënyrë kompjuterike, sepse të njëjtat fjalë me përbërje të njëjtë leksikore, merrnin kuptime e përdorime të reja gjatë zhvillimit të ngjarjeve. **Së pesti**, të paraqesim jetën e fjalëve, ndryshimet që ata kanë pësuar gjatë kohëve me tejbajtje, zgjerim a zvogëlim e specializim kuptimi, duke kaluar nga një familje fjalësh për të dalë më vete, pra duke formuar tani një vatrë të re leksikore. **Së fundi**, duke rreshtuar fjalë që deri më tani kishin ngelur të pashpjeguara, sepse nuk dilnin ndër fjalorë të shqipes, me gjasë ose se nuk njiheshin, ose klasifikoheshin si krahinore a dialektore.

Duke lexuar *Lahutën* e duke parë aty pasurinë e madhe leksikore, vetiu të lindte pyetja: “A u plak Fishta, apo është varfëruar shqipja?”

Ky studim mbyllet me një thënie lapidare të shkrimtarit kosovar, Sabri Hamiti, ku shkruhet: “Për shqiptarët veriakë, si unë, Fishta është diçka më shumë se një poet; ai është një pikë e fortë identifikimi, me një gjuhë me hapësirë enciklopedike të brezit të shkuar, me një karakter të papërkuljes dhe kryengritës, më në fund si pikë mbështetjeje, referimi e identifikimi me Shkodrën, kryeqytetin e moçëm kulturor të shqiptarëve”.⁶⁸

Në shkrimin e dytë *“Fjalë të rralla në veprën e Gjergj Fishtës ‘Lahuta e Malcis’*, përfshihen rreth 2500 fjalë të kësaj natyre. Shpjegimi i fjalëve të *Lahutës*, të rreshtuara në vendin përkatës, përbënte një çështje më vete, veçanërisht për foljet, që detyrimisht jo vetëm do të viheshin në trajtën e paskajores, por edhe duhet të shpjegoheshin po me të njëjtën trajtë. Përndryshe kuptimi i tyre nuk dilte i saktë dhe i plotë. Po kështu edhe nevoja e përdorimit të disa shprehjeve dialektore të gegërishtes, të cilat e jepnin më të plotë kuptimin e fjalëve. Kemi, pra, në tekstin e përdorur prej meje në shpjegimin e fjalëve disa herë një përzierje të standardit me trajtat dialektore të gegërishtes. Ngjan që nuk kemi këtu një *thyerje* të *standardit*, por mbase një mënyrë për ta pasuruar atë.

Për të mënjnauar keqkuptimet në përdorimin e termave *dialektalizëm* e *krahinorizëm* duhet detyrimisht të mbajmë parasysh së pari, përkufizimet e dhëna për këto terma në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* 1980⁶⁹; së dyti, shtjellimet dhe analizën e bërë nga J. Thomai në veprën *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*⁷⁰ dhe, së treti, të pranojmë marrëveshjen për “... një kriter dallues të përafërt ndërmjet dialektalizmave e krahinorizmave; kur

⁶⁸ S. Hamiti, *Letërsia moderne* 8, f. 92.

⁶⁹ *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980, f. 330 e 879.

⁷⁰ J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 9-33.

fjala, që nuk e ka gjuha letrare, gjendet vetëm në një të folme ose në të folmet vetëm të një krahine, të merret si krahinorizëm, kur fjala gjendet në tërë dialektin ose në disa të folme të një dialekti ... të merret si dialektalizëm; si dialektalizëm, në kuptim të gjerë, të merret edhe çdo fjalë e një dialekti (dialektore a krahinore), përballë gjuhës letrare”.⁷¹ Tani, pikërisht te konceptimi i fjalëve krahinore⁷², nis edhe diskutimi për problemin që po trajtojmë, sepse dialektet (e këtu edhe fjalët krahinore) janë burimi kryesor i pasurimit të mëtejshëm të gjuhës standard.⁷³ Në qoftë se *standardi* nuk do të ushqehet vazhdimisht nga gjuha e gjallë e popullit, ai rrezikon të kthehet në një gjuhë të elitës. Shembull i qartë për këtë është latinishtja në raport me gjuhët e rrjedha prej saj. E për rastin e këtyre fjalëve te *Lahuta*, nuk po veprojmë me konceptet tona për fjalët *krahinore* apo *dialektore*, por me konceptet marksiste të gjuhësisë zyrtare të kohës së komunizmit. Sepse edhe sipas këtyre koncepteve, apo “*normës leksikore*” të asaj kohe, fjalët e “*Lahutës*” duhet të ishin përfshirë të gjitha në *Fjalorin* e vitit 1980. Sepse, edhe sipas A. Kostallarit (në shkrimin programatik *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*⁷⁴), “Vlerësimi i çdo fjale-leksemë (për ta futur ose jo në *Fjalor*) duhet të bëhet në radhë të parë, jo sipas burimit dialektor, as sipas burimit lokal, por sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare, duke marrë parasysh kryesisht dy aspekte, të lidhura organikisht midis tyre: a) a i sjell fjala leksikut të sotëm letrar ... ndonjë pasurim, zhvillim të mëtejshëm (p.sh. a shënon ajo nocione të reja ose a sjell nuanca të reja kuptimore ...”

Me interes paraqitet edhe përkthimi i këngës XXII të “*Iliadës*” së Homerit, nga Frano Alkaj, të cilit i kemi kushtuar një shkrim të veçantë, sepse: “autori ka qenë i ndërgjegjshëm se pa përzgjedhjen e fjalëve të krejt pasurisë së leksikut të shqipes, ai nuk do të mund ta përkthente denjësisht këtë këngë të “*Iliadës*”, e cila është më e vështira, më e bukura, më madhështorja, por edhe

⁷¹ Po aty, f. 21.

⁷² Këtu bëhet fjalë për përcaktimin teorik të termit *fjalë krahinore* e jo për përdorimin e tij në *Fjalor* 1980, ku *krahin.* ngjan të jetë dhënë për dubletat e ngjyrimin stilistik (khs. *keç/e~ja* “vajzë e vogël, gocë, vajzë”, *Fjalor* 804). Khs. edhe P. Haxhillazi, *Rreth karakteristikave stilistike të fjalëve në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”* (1980), në rev. “*Studime filologjike*”, nr. 3, 1986, f. 162, ku shkruhet: “Shënimi *krahin.* u është vënë atyre krahinorizmave që zakonisht kanë një sinonim në gjuhën letrare”.

⁷³ J. Thomai shprehet kështu: “Veçoritë e fazës së tanishme të përpunimit ... të gjuhës letrare shqipe i japin leksikut dialektor e krahinor statusin e një shtrese leksikore me vlera të dorës së parë” (*Rreth leksikut popullor në të folmet verilindore të shqipes*, në “*Studime filologjike*” 1987/2, f. 61).

⁷⁴ A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”*, në rev. “*Studime filologjike*”, 1968/2.

më e pasura me elemente konkrete e, gjithashtu, të atyre të sferës abstrakte, të cilat përbëjnë thelbin e saj.”

Kjo pasuri e madhe fjalësh e shprehjesh të gjuhës shqipe, të përdorura në këtë përkthim, do t’i japë dorë autorit t’i afrohet shumë pranë origjinalit dhe, në disa raste, të njësojë këngët tona epike të Veriut me ato të Homerit, duke na krijuar përshtypjen se jemi në një hapësirë me katër dimensione.

Përdorimi mjeshhtëror i fjalëve për të ndërtuar këngët e “Iliadës”, na tregon se shqipja është e hapët për të përkthyer kryevepra botërore jo vetëm duke mos ua prishur atyre bukurinë, por duke i pasuruar edhe me elemente të reja.

Në vazhden e kësaj pune ne kemi analizuar edhe pasurinë gjuhësore të **“Kanunit të Lekë Dukagjinit”** (Sh. Gjeçovi) dhe të **“Prallave kombtare”** (D. Kurti); duke i paraprirë nga një *Hyrje*, e më pas duke dhënë *Fjalorin* e tyre me shpjegime dhe analiza filologjike.

Vëllimi i tetë përmbyllet me dy shkrime. I pari, me titull **“Përpyesëtimi i leksikut të autorëve gegë në Fjalorin e vitit 1980”**, botuar në *Studime gjuhësore* IX, ka një histori më vete. Në “Seminarin XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, mbajtur në Prishtinë nga data 18 gusht deri me 31 gusht 2003⁷⁵, lexova kumtesën me titull *Ndihmesa e Fishtës, Koliqit dhe Camajt për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe (Statistikë gjuhësore)*. Në hyrje të kësaj kumtese shkruaja: “Në kapitullin e parë të veprës sime *“Studime gjuhësore”* VIII, që besoj se do ta shohë dritën e shtypit në fund të këtij viti, kam shtruar pyetjen “A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard?”, me përpjekjen edhe për t’i dhënë rrugë këtij problemi. Në këtë kumtesë, qëllimisht të shkurtuar e të thjeshtëzuar, do të parashtroj vetëm një pjesë të vogël të përfundimeve të arritura, mbështetur në analizën e statistikave gjuhësore (kryesisht në strukturën leksikore e fjalëformuese) për veprat e tre autorëve të mëdhenj të letrave shqipe, Fishtës, Koliqit dhe Camajt.”⁷⁶

Në fund të kësaj kumtese kisha shkruar “Përfundimisht mund të themi se rreth 30% i leksikut të gegërishtes nuk përfshihet në *Fjalorin* e vitit 1980.”⁷⁷

Këtë përfundim do ta përsërisja sërish në vëllimin *Studime gjuhësore* VIII, po tani të arsyetuar mbi një bazë statistikore mjaft të gjerë.⁷⁸

Në Seminarin e Prishtinës, për përfundimin e mësipërm u shfaqën dy mendime të kundërta, një palë e mbështesnin duke e miratuar atë, të tjerë e kundërshtonin, duke e quajtur përfundim a priori. Të dy palët tani kërkonin mbështetje statistikore konkrete. Bash për këtë shkak ne iu rikthyem për së treti

⁷⁵ Sesionin shkencor me temë “Fjalëformimi i gjuhës shqipe - Të folmet arbëreshe”, dt. 29-30 gusht 2001.

⁷⁶ D. Luka, SGJ IX 29.

⁷⁷ *Po aty*, f. 35.

⁷⁸ D. Luka, *A mund të zgjerohet baza dialektore e shqipes standard?*, SGJ VIII 43.

këtij problemi, po tani duke shkruar: “Duke iu rikthyer edhe një herë këtij problemi kaq të rëndësishëm për gjuhën shqipe, do të përpiqem të zgjeroj këndvështrimin tani jo vetëm mbi anën sasiore të leksikut, po veçanërisht edhe për anën cilësore të tij, gjithsesi në bashkëlidhje edhe me kriteret e përdorura në përzgjedhjen (e më pastaj në përfshirjen) e fjalëve në *Fjalorin* e sipërpërmendur nga hartuesit e tij.”⁷⁹

Tani përfundimi im mbështetet mbi një leksik të zgjedhur të 6 autorëve gegë: Alkaj, Shllaku, Fishta, Palaj, Koliqi, Camaj. Analiza statistikore përkatëse përmbledhet në tabelën e mëposhtme.

	Alkaj	Shllaku	Fishta	Palaj	Koliqi	Camaj
Fjalë	71	88	500	358	177	299
Nuk janë	25	33	168	172	79	101
%	35	37	33.6	48	44.6	34.3

Sipas kësaj table mund të nxirret ky përfundim: nga 1493 fjalë të marra në analizë ndër gjashtë autorët e sipërm, 578 nuk dalin në *Fjalorin* 1980 (përkat. 38.8%). Duke marrë parasysh se një pjesë e vogël e këtyre fjalëve përsëriten te autorë të ndryshëm, përqindja e saktë del përafërsisht rreth 30%.⁸⁰

Për Fishtën, kemi shkruar një artikull me titull *Ndihmesa e Fishtës për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare shqipe*, të cilin e kemi botuar në revistën “Studime filologjike” në vitin 2001. Aty edhe tabela përkatëse me analizën statistikore të një leksiku të zgjedhur prej 500 fjalësh nga *Lahuta e Malcís*.

Autori	Fishta	Meyer	Krist.	Bashk.	Gazull.	Fjalor	Kolgj.	Fjalor
Viti	1937	1891	1904	1911	1941	1954	1969	1980
Nr. i fj.	500	87	106	336	119	358	410	332
%	100	17.4	21.2	67.2	23.8	71.6	82	66.4

⁷⁹ SGJ IX 7.

⁸⁰ SGJ IX 9.

Përpjesëtimi dilte kështu: nga 500 fjalët e përzgjedhura nga Fishta qenë futur në *Fjalor* (1980) 332 prej tyre me një mesatare 66.4%. Kishin ngelur jashtë 168 fjalë, që autorët e *Fjalorit*, mbështetur te kriteret e vendosura për hartimin e këtij *Fjalori*, i kishin çmuar si tepër dialektore (përkat. edhe krahinore). Megjithëkëtë një përqindje e tillë paraqitej e kënaqshme. Fjalët e Fishtës, në një pjesë të vogël e të parëndësishme, i qenë nënshtruar makrosistemit ku do të strehoheshin. Kjo ishte punë që duhej bërë, sepse fjalët që paraqiteshin me zanore hundore në fund të tyre p.sh., nuk mund të ndërkalleshin në *Fjalor* pa u prekur. Khs. te Fishta *flakadâ, lutrâ, murrâ, kacadrê* etj. që në *Fjalor* dalin përkat. *flakadan, lutran, murran, kacadren* etj. Po kështu përkat. *katue, mrû (me), rrmiqe, rrmore, vigëm* te Fishta, në *Fjalor* dalin *katua, mbruhem, rrëmiqe, rrëmorie, vigmë* etj.⁸¹ Për autorët e tjerë gegë kisha bërë vjeljet përkatëse, duke i botuar tanimë në *Studimet* tona gjuhësore. (Khs. *Fjalor i fjalëve të rralla në “Veprën poetike” të Bernardin Palajt*⁸²; *Fjalorth i fjalëve të rralla në veprën “Pasqyrat e Narçizit” të Ernest Koliqit*⁸³; *Fjalorth i fjalëve të rralla në prozën “Pishtarët e natës” të Martin Camajt*⁸⁴; *Fjalorth i fjalëve të rralla në veprën “Anzat e Parnasit” të Gjergj Fishtës*⁸⁵). Mbi këtë bazë ne tani e kishim më të lehtë të nxirrnim përfundime statistikore.

Për t’u bindur për cilësinë e fjalëve, të rreshtuara te autorët e mësipërm gegë, të cilat nuk dalin në *Fjalorin* e vitit 1980, janë përzgjedhur nga 30 fjalë tek tre autorë: Palaj, Koliqi e Camaj, të cilat janë renditur sipas një tablele.

Në tabelën e sipërpërmendur bie në sy se shumica e tyre janë fjalë që shprehin nocione të reja a emërtojnë objekte a dukuri të reja, për të cilat gjuha shqipe nuk ka fjalë të tjera. Pra shtojnë ndjeshëm fondin e fjalëve të shqipes. Ndërkaq dalin këtu edhe fjalë të parme (ndaj rrjedhojave të rreshtuara në *Fjalorin* 1980), rrjedhoja të fjalëve që janë të regjistruara në *Fjalor*, fjalë onomatopeike, kompozita të reja, të formuara sipas gjedhes së gjuhës shqipe etj. Fjalët e mësipërme, pra, plotësojnë një më një kushtet (përkat. *normën leksikore*) për të qenë të pranishme në *Fjalor*, duke u mbështetur tani në vlerësimet e vetë Kostallarit (si edhe studiuesve të tjerë) për zgjedhjen e fjalëve. Nuk plotësojnë ndërkaq mbase njërin nga kushtet politike, sepse të gjithë autorët e marrë në shqyrtim më lart, kanë qenë me *biografi* të keqe. Kriteri politik ka qenë kryesori në kohën e diktaturës komuniste. Kundërshtarët e regjimit, tani dihet e stërdihet, përjashtoheshin nga të gjitha botimet e asaj kohe. Atyre që e ndaluar t’u përmendej emri.⁸⁶

⁸¹ *Po aty*, f. 30 v.

⁸² SGJ VIII 60.

⁸³ SGJ VIII 74.

⁸⁴ SGJ VIII 83.

⁸⁵ SGJ IX 36.

⁸⁶ SGJ IX 20 v. me gjithë bibliografi.

Në këtë situatë ne përpiqemi të gjejmë shkaqet a arsyet që i kanë shtyrë hartuesit e *Fjalorit* 1980 t'i përjashtojnë këto fjalë nga shqipja e sotme.

Ne dyshojmë se ndaj fjalëve të rralla (përkat. dialektore a krahinore) të gegërishtes është mbajtur (në rastin më fatlum) një qëndrim në mospërfillës, së paku i shkujdesur. Këtu nuk është fjala vetëm sepse hartuesit e *Fjalorit* kanë qenë pothuaj të gjithë toskë, por edhe për drejtimin e përgjithshëm që në këtë kohë përcaktonte zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe. Ngjan të kemi këtu edhe një shfaqje latente ndaj 6 autorëve gegë, që për fat të keq, cilësoheshin në atë kohë *reaksonarë* (disa prej tyre edhe me thundra, duke shtuar këtu edhe *zhgunin* a *veladonin*, që shumëkujt i vriste sytë). Një gjendje e tillë ngjan vazhdon edhe sot e kësaj dite, thjesht për inerci.⁸⁷

Mospërfshirja e këtyre fjalëve të gegërishtes në *Fjalorin* 1980 (me dashje a pa dashje, duke nënkuptuar këtu parimet nga janë udhëhequr hartuesit e tij) ka sjellë dy të këqia të mëdha, e me gjasë tani edhe të pariparueshme. Së pari, është varfëruar leksiku i gjuhës shqipe, sepse në mjaft raste janë hequr fjalë të gegërishtes që nuk kanë përgjegjëse në toskërishte dhe, së dyti, letërsia e traditës gege, që deri në njëfarë mase përfaqësohet nga shkrimtarët e përmendur më lart, është bërë e pakuptueshme, duke i kaluar tani historisë së letërsisë. Shembull i qartë për të vërtetuar sa thashë më lart është vepra e Gjergj Fishtës *Lahuta e Malcís*.⁸⁸

Për këtë gjendje paradoksale, në të cilën ndodhemi, për ringjalljen e letërsisë së traditës, *fjala* e këtyre shkrimtarëve është e para që duhet marrë në analizë, duke u kryer jo vetëm studime përmbi të, por edhe duke u përpjekur për ta vënë në përdorim të përditshëm tonin. Përndryshe autorë si Fishta me shokë do t'i kalojnë përgjithmonë historisë së letërsisë e vetëm do të kujtohen në përvjetorë të vdekjeve të tyre. E gjithkush e kupton se një veprim i tillë është në dëm të kulturës kombëtare.⁸⁹

Te tjetri me titull ***“Leksiku historik i gjuhës shqipe” (Çështje parimesh e metode)***, bëhen përpjekje për të ndihmuar në hartimin e një “Fjalori historik” të gjuhës shqipe, shtruar si një kërkesë e domosdoshme për punën e mëtejme të historianëve të gjuhës shqipe.

⁸⁷ SGJ IX 18 me gjithë bibliografi.

⁸⁸ *Po aty*, f. 24 v.

⁸⁹ *Po aty*, f. 27 v me gjithë bibliografi.